



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 29 nëntor 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës

---

**T'u njoftohet:**

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës**

Zhan-Lui Zhilisen

**Kryetares**

Ekaterina Trendafilova

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Administratores**

Fidelma Donlon

**Qeverisë së Kosovës**

Kryeministrit

Ministres së Drejtësisë

**PËRMBAJTJA**

I.	HISTORIKU PROCEDURAL .....	2
II.	KUADRI I ÇËSHTJES GJYQËSORE .....	7
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE DHE PARIMET PËR ZHDËMTIMET .....	9
A.	Tekstet dhe instrumentet ligjore përkatëse .....	9
B.	Parimet për zhdëmtimet: pasqyrë e përgjithshme .....	11
C.	Përfituesit e zhdëmtimeve .....	15
D.	Dëmi .....	17
E.	Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimeve .....	21
F.	Përgjegjësia e personit të shpallur fajtor për zhdëmtim .....	24
IV.	PROVAT E ADMINISTRUARA PREJ TRUPIT GJYKUES DHE METODOLOGJIA E TRUPIT GJYKUES PËR VLERËSIMIN E KËRKESËS PËR ZHDËMTIME .....	25
V.	SHKALLA DHE MASA E DËMIT .....	27
A.	Parashtrimet .....	27
B.	Identiteti si person fizik .....	28
C.	Dëmi i pësuar nga viktimat .....	29
VI.	URDHRI PËR ZHDËMTIM KUNDËR Z. SHALA .....	44
A.	Përfituesit e zhdëmtimeve dhe dëmi i pësuar .....	44
B.	Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimeve .....	45
C.	Shkalla e përgjegjësisë së z. Shala për zhdëmtimet .....	48
VII.	VËNIA NË JETË DHE ZBATIMI I URDHRI PËR ZHDËMTIM .....	70
A.	Monitorimi dhe mbikëqyrja .....	70
B.	Financimi .....	71
VIII.	VENDIM .....	81

**TRUPI GJYKUES I** ("Trupi Gjykues") lëshon këtë Urdhër për Zhdëmtim kundër Pjetër Shalës (z. Shala).

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Shala.<sup>1</sup>
2. Më 15 dhjetor 2021, 11 gusht 2022, dhe 19 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi gjithsej tetë viktimat për pjesëmarrje në proces (së bashku, viktimat).<sup>2</sup>
3. Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues.<sup>3</sup>
4. Më 9 shkurt 2023, Trupi Gjykues vendosi që procesi i zhdëmtimit, në çështjen aktuale, të kryhet njëkohësisht me procesin penal dhe se, në rast të verdiktit të fajësisë, të mos i referonte viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës, por të lëshonte vetë urdhrin për zhdëmtim.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës* ("Vendimi i Konfirmimit), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00007/CONF/RED dhe [F00007/RED](#), u dorëzuan më 6 maj 2021. Më 1 nëntor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) parashtrori versionin e korrigjuar të aktakuzës së konfirmuar (Aktakuza e Konfirmuar), KSC-BC-2020-04, F00098/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 1 nëntor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 nëntor 2021, [F00107/A01](#).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 15 dhjetor 2021, konfidencial, para. 50(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00123/RED](#); F00249, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 11 gusht 2022, konfidencial, para. 43(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00249/RED](#); F00279, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 19 shtator, konfidencial, para. 43(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00279/RED](#).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00284, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Decision Transmitting the Case File to Trial Panel I* (Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykues I), 21 shtator 2022, publik, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00421, Trupi Gjykues I, *Decision on reparation proceedings* (Vendim mbi Procesin e Zhdëmtimit) 9 shkurt 2023, publik.

5. Më 21 shkurt 2023, gjykimi filloi me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave dhe Mbrojtja e z. Shala (Mbrojtja) bëri deklaratën hyrëse më 22 shkurt 2023.<sup>5</sup>
6. Më 24 shkurt 2023, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave Gjatë gjykimit dhe Çështje lidhur me To.<sup>6</sup>
7. Nga 27 marsi 2023 deri më 6 korrik 2023, ZPS-ja paraqiti provat e veta.<sup>7</sup>
8. Më 4 maj 2023, përmes urdhrit gojor, Trupi Gjykses përcaktoi hapat e mëtejshëm proceduralë për paraqitjen e provave nga Mbrojtësi i Viktimave (Urdhri Gojor i 4 Majit).<sup>8</sup>
9. Më 30 qershor 2023, Mbrojtësi i Viktimave paraqiti dy aktekspertiza (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të datës 30 qershor 2023)<sup>9</sup> – një lidhur me dëmin fizik dhe mendor që iu shkaktua V01/04-ës dhe një lidhur me dëmin material që pësuan viktimat (Aktekspertiza e iMMO-s<sup>10</sup> dhe Aktekspertiza *Lerc*,<sup>11</sup> së bashku

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00405, Trupi Gjykses I, [Decision on the date for the commencement of the trial, evidence presentation and related matters](#) (Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, Paraqitjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të (“Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit”), 26 janar 2023, publik, f. 497, rreshtat 11-12; f. 502, rreshti 21 deri f. 503, rreshti 9; [T. 22 February 2023](#) (T.22 shkurt 2023), publik, f. 570, rreshtat 17-20.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00433, Trupi Gjykses I, [Decision on victims’ procedural rights during trial and related matters \(Victims’ Procedural Rights Decision\)](#) (Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit dhe Çështje lidhur me To (“Vendimi për të Drejtat Procedurale të Viktimave”), 24 shkurt 2023, publik.

<sup>7</sup> [T. 27 mars 2023](#) (T. 27 mars 2023), publik, f. 609, rreshtat 11-13; KSC-BC-2020-04, F00570, Prokurori i Specializuar, [Prosecution notice of the closing of its case pursuant to Rule 129](#) (Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave në përputhje me Rregullën 129), 6 korrik 2023, publik.

<sup>8</sup> [T. 4 maj 2023](#) (T. 4 maj 2023), publik, f. 1356, rreshti 11 deri f. 1361, rreshti 6.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-04, F00558, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave*, 30 qershor 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-6, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 gusht 2023, [F00558/RED](#).

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-04, F00558/A01, *SHTOJCA 1 e Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave*, 30 qershor 2023, konfidenciale.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-04, F00558/A04, *SHTOJCA 4 e Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave*, 30 qershor 2023, konfidenciale.

Aktekspertizat e Mbrojtësit të Viktimave) – dhe kërkoi nga Trupi Gjykses të thërriste dy nga tre ekspertët për të dhënë dëshmi.

10. Më 10 korrik 2023, Mbrojtja bëri me dije se nuk synonte të kundërshtonte kualifikimet e ekspertëve, të cilët përpiluan Aktekspertizën e iMMO-së dhe Aktekspertizën *Lerc*.<sup>12</sup>

11. Më 21 gusht 2023, Mbrojtësi i Viktimave thirri dy dëshmitare eksperte (ekspertet e iMMO-s), me lejen e Trupit Gjykses.<sup>13</sup> Gjatë gjykimit, Trupi Gjykses dëgjoi edhe dëshmitë e pesë (5) viktimave pjesëmarrëse në proces.

12. Nga 20 shtatori 2023 deri më 15 janar 2024, Mbrojtja paraqiti provat e veta.<sup>14</sup>

13. Më 11 tetor 2023, Mbrojtja parashtroi pyetje lidhur me Aktekspertizën *Lerc*,<sup>15</sup> dhe më 27 tetor 2023, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi përgjigjet në lidhje me to.<sup>16</sup>

14. Më 25 tetor 2023, përmes urdhrit gojor, Trupi Gjykses pranoi si provë Aktekspertizën e iMMO-së.<sup>17</sup>

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-04, F00578, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Mbrojtësit të Viktimave në zbatim të Urdhrit të Trupit Gjykses të 4 Majit 2023*, 10 korrik 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 korrik 2023, [F00578/RED](#).

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-04, F00598, Trupi Gjykses I, *Decision on Victims' Counsel's request to call expert witnesses to testify* (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të Thirrur Dëshmitarë Ekspertë për të Dëshmuar ) 21 korrik 2023, publik, para. 12(a); [T. 21 August 2023](#) (T. 21 gusht 2023), publik f. 2249, rreshtat 13-16.

<sup>14</sup> [T. 20 September 2023](#) (T. 20 shtator 2023), publik, f. 2450, rreshtat 12-14; KSC-BC-2020-04, F00772, Mbrojtja, *Defence Notice of Closing its Case Pursuant to Rule 131 of the Rules* (Njoftim i Mbrojtjes për Mbylljen e Paraqitjes së Provave në përputhje me Rregullën 131 të Rregullores), 15 janar 2024, publik.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-04, F00687, Mbrojtja, *Defence Submission of Written Questions for Victims' Counsel's Expert Witness* (Parashtrimi i Pyetjeve me Shkrim të Mbrojtjes për Dëshmitarin Ekspert të Mbrojtësit të Viktimave), 11 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-04, F00696, Mbrojtësi i Viktimave, *Victims' Counsel, Victims' Counsel's Submission of Expert's Answers to Written Questions from the Defence (Victims' Counsel Expert Answers)* (Parashtrimi i Pyetjeve me Shkrim të Mbrojtjes për Dëshmitarin Ekspert të Mbrojtësit të Viktimave) (Përgjigjet e Ekspertit të Mbrojtësit të Viktimave), 27 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>17</sup> [T. 25 October 2023](#) (T. 25 tetor 2023), publik, f. 3151, rreshti 9 deri f. 3153, rreshti 8.

15. Më 13 nëntor 2023, Mbrojtja paraqiti aktekspertizën e vet lidhur me humbjet ekonomike të viktimave pjesëmarrëse në proces (Aktekspertiza e Mbrojtjes).<sup>18</sup> Më 27 nëntor 2023, Mbrojtësi i Viktimave parashtroi pyetje lidhur me Aktekspertizën e Mbrojtjes,<sup>19</sup> dhe më 6 dhjetor 2023, Mbrojtja dorëzoi përgjigjet në lidhje me to.<sup>20</sup>

16. Më 9 shkurt 2024, Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave<sup>21</sup> dhe kërkoi nga Mbrojtësi i Viktimave të dorëzonte kërkesën për zhdëmtime deri më 4 mars 2024 dhe deklaratën në lidhje me pasojat e krimeve të pretenduara mbi viktimat (Deklarata mbi Pasojat) deri më 25 mars 2024.<sup>22</sup>

17. Më 4 mars 2024, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi kërkesën për zhdëmtim (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim).<sup>23</sup>

---

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-04, F00716/A01, Mbrojtja, *Parashtrim prej Mbrojtjes i një Aktekspertize në kuadër të Procesit të Zhdëmtimit*, 13 nëntor 2023, konfidencial.

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-04, F00728, Mbrojtësi i Viktimave, *Pyetje të Mbrojtësit të Viktimave për Ekspertin e Mbrojtjes* (Pyetjet e Mbrojtësit të Viktimave për Ekspertin e Mbrojtjes), 27 nëntor 2023, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 dhjetor 2023, [F00728/RED](#).

<sup>20</sup> KSC-BC-2020-04, F00736, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes në lidhje me Përgjigjet e Ekspertit të Mbrojtjes ndaj Pyetjeve me Shkrim të Mbrojtësit të Viktimave*, 6 dhjetor 2023, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 dhjetor 2023, [F00736/RED](#).

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-04, F00795, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin për Vizitë në Vendin e Krimit, Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Udhëzime në lidhje me Dosjet Paraprake, Kërkesën për Zhdëmtime dhe Deklaratat Përmbyllëse*, 9 shkurt 2024, konfidencial, para. 23, 52(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 20 shkurt 2024, [F00795/RED](#).

<sup>22</sup> [Decision Closing Evidentiary Proceedings](#) (Vendimi mbi Mbylljen e Paraqitjes së Provave), para. 36, 41, 52(g), (h).

<sup>23</sup> KSC-BC-2020-04, F00804, Mbrojtësi i Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim në lidhje me Dëmin Fizik, Mendor dhe Material të Pësuar nga Viktimat Pjesëmarrëse në Proces*, 4 mars 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 gusht 2024, [F00804/RED](#).

18. Më 25 dhe 26 mars 2024, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave dorëzuan, përkatësisht, dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Deklaratën mbi Pasojat.<sup>24</sup> Ata dhanë deklaratat përmbyllëse midis 15 dhe 17 prillit 2024.<sup>25</sup>
19. Më 25 mars 2024, Mbrojtja dorëzoi përgjigjen e saj ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim (Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim).<sup>26</sup>
20. Më 17 prill 2024, Kryegjykatësja e mbylli çështjen gjyqësore.<sup>27</sup>
21. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjyqësor shqiptoi në seancë të hapur aktgjykimin kundër z. Shala,<sup>28</sup> duke e shpallur fajtor për krime lufte dhe duke e dënuar me 18 vjet burgim (Aktgjykimi).<sup>29</sup> Trupi Gjyqësor bëri të ditur se më vonë do të lëshonte Urdhrin për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe se kishte juridiksionin e nevojshëm për këtë qëllim.<sup>30</sup>

---

<sup>24</sup> KSC-BC-2020-04, F00818, Prokurori i Specializuar, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë* ("Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së"), 25 mars 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1 dhe 3, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike (Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 gusht 2024, [F00818/RED](#)); F00821, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes* ("Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes"), 26 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00815, Mbrojtësi i Viktimave, *Deklaratë e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve të Pretenduara për Viktimat Pjesëmarrëse në Procesin e Çështjes Gjyqësore 04* ("Deklarata mbi Pasojat"), 25 mars 2024, konfidenciale (Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 gusht 2024, [F00815/RED](#)).

<sup>25</sup> T. 15 prill 2024, konfidencial, f. 4080-4168; T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4172-4280; T. 17 prill 2024, konfidencial, f. 4283-4374.

<sup>26</sup> KSC-BC-2020-04, F00819, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim në Lidhje me Dëmin Fizik Mendor dhe Material të Pësuar nga Viktimat Pjesëmarrëse në Proces*, 25 mars 2024, konfidencial. Trupi Gjyqësor thekson se, sipas një vendimi të fundit, versionet e redaktuara publike të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes dhe Përgjigjes së Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim nuk janë dorëzuar ende, *shih* KSC-BC-2020-04, F00865, Trupi Gjyqësor, *Vendim mbi Parashtrimin e Përbashkët lidhur me Redaktimet e Propozuara për Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes dhe Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim*, 28 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00865/RED.

<sup>27</sup> [T. 17 prill 2024](#), (T. 17 prill 2024), publik, f. 4374, rreshtat 9-10.

<sup>28</sup> [T. 16 korrik 2024](#), (T. 16 korrik 2024), publik, f. 4375-4396.

<sup>29</sup> KSC-BC-2020-04, F00847, Trupi Gjyqësor I, *Aktgjykim dhe Dënim*, 16 korrik 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 shtator 2024, [F00847/RED](#).

<sup>30</sup> *Shih* Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 1042, 1127.

## II. KUADRI I ÇËSHTJES GJYQËSORE

22. Trupi Gjykses rikujton se, sikurse është përcaktuar në Aktgjykimin, në këtë çështje gjyqësore krimet u kryen afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, në kontekstin dhe në lidhje me konfliktin e armatosur jondërkombëtar midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në njërin anë, të njohur në anglishte si *Kosovo Liberation Army* (KLA), dhe, në anën tjetër, forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si edhe grupe të tjera që luftonin në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, që ndodhi në periudhën e krimeve të paraqitura në aktakuzë.<sup>31</sup>

23. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstatoi se, z. Shala, shtetas i Kosovës, i lindur më 17 shtator 1963, në Prizren, Kosovë, luajti rol aktiv në ndalimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin sistematik të personave në Fabrikën e Metalit në Kukës (FMK), një fabrikë e dikurshme e metalit në Kukës, Shqipëri.<sup>32</sup> Gjatë periudhës që lidhet me akuzat, FMK shërbente si shtab i UÇK-së në dhe u përdor për qëllime të ndryshme, ndër të cilat rekrutim, mobilizim dhe logjistikë.<sup>33</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar se FMK u përdor edhe nga disa anëtarë të UÇK-së për të ndaluar, marrë në pyetje dhe keqtrajtuar personat që konsideroheshin si “spiunë” ose “tradhtarë”, ose se bashkëpunonin, ishin të lidhur ose simpatizonin autoritetet serbe, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>34</sup> Qëllimi i këtij keqtrajtimi brutal ishte për të marrë prej tyre informata ose deklarata pranuese, për t’i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar dhe/ose diskriminuar ata për arsye politike.<sup>35</sup> Edhe pse nuk dihet numri i gjithsejtë i personave që u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, vlerësohet se

<sup>31</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 919 dhe në vijim.

<sup>32</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 284, 903-914, 1015, 1028, 1104.

<sup>33</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 306-307.

<sup>34</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 336-363, 587-591, 748-753, 1009-1015.

<sup>35</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 983-984.



ishin rreth 40 persona. Trupi Gjykses arriti të identifikonte tetëmbëdhjetë (18) persona të cilët u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>36</sup>

24. Z. Shala, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së në FMK, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët (forma bazë), mori pjesë në ndalimin arbitrar të së paku tetëmbëdhjetë (18) personave, të cilët u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese.<sup>37</sup> Z. Shala ishte fizikisht i pranishëm në FMK në disa raste dhe mori pjesë personalisht në transferimin në FMK të njërit prej të ndaluarve dhe në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e vazhdueshëm të disa të ndaluarve.<sup>38</sup> Ai mori pjesë gjithashtu në keqtrajtimin brutal të njërit prej të ndaluarve, i cili vdiq pasi Xhemshit Krasniqi, në prani të z. Shala e qëlloi në këmbë me armë zjarri (viktima e vrasjes së paligjshme).<sup>39</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme vdiq më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur ende mbahej i ndaluar në FMK, si pasojë e plagëve të shkaktuara me armë zjarri, ndërthurur me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.<sup>40</sup>

25. Trupi Gjykses konstatoi se z. Shala, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, kishin qëllimin e përbashkët për të ndaluar arbitrarisht, marrë në pyetje, torturuar dhe vrarë të ndaluarit në FMK, të cilët konsideroheshin si “spiunë” ose “tradhtarë” ose se bashkëpunonin, ishin të lidhur ose simpatizonin autoritetet serbe, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>41</sup> Përmes pjesëmarrjes së tij në transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK, z. Shala dha kontribut të qenësishëm në realizimin e qëllimit të përbashkët.<sup>42</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e shpalli fajtor z. Shala, si pjesëtar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (forma bazë), për tri akuza për krime luftime, konkretisht ndalim arbitrar, torturë dhe

---

<sup>36</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 589-591.

<sup>37</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1025-1028, 1037-1039.

<sup>38</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1025.

<sup>39</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 830-832, 1025.

<sup>40</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 778, 832.

<sup>41</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1022, 1024.

<sup>42</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1025-1028.

vrasje të paligjshme,<sup>43</sup> dhe e dënoi me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim që nga 16 marsi 2021.<sup>44</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE DHE PARIMET PËR ZHDËMTIMET

#### A. TEKSTET DHE INSTRUMENTET LIGJORE PËRKATËSE

26. Trupi Gjykses u referohet neneve 6(1) dhe 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“KEDNJ”),<sup>45</sup> neneve 2(3) dhe 14(1) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (“MNDCP”),<sup>46</sup> nenit 14 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerezore dhe Poshtëruese (“KKT”),<sup>47</sup> neneve 22 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (përkatësisht “Kushtetuta” dhe “Kosova”), neneve 3, 22, 23, 34(1), 43 dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullave 80, 159(5) dhe 168 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

27. Trupi Gjykses thekson në veçanti se në fjalinë e parë të nenit 22(3) të Ligjit, përcaktohet se “interesi personal i viktimës dhe të drejtat e viktimës në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe *zhdëmtimi*” [theksimi i shtuar].

28. Në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, “kur trupi gjykses ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim, ai mund të nxjerrë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku specifikon

---

<sup>43</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1037-1039.

<sup>44</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1123, 1125.

<sup>45</sup> [European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms](#) as amended by Protocols Nos. 11, 14, and 15, supplemented by Protocols Nos. 1, 4, 6, 7, 12, 13 and 16, 4 November 1950, ETS 5.

<sup>46</sup> [International Covenant on Civil and Political Rights](#) 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171.

<sup>47</sup> [Convention Against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment](#) 10 December 1984, United Nations, Treaty Series, vol. 1465, p. 85.

zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ato viktima”.

29. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se mund të lëshojë urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor, në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, vetëm pasi të ketë përcaktuar shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen gjyqësore në fjalë, në përputhje me nenin 22(7) të Ligjit dhe rregullën 168 të Rregullores. Po ashtu, siç kërkohet në fjalinë e parë të nenit 22(7) të Ligjit, vendimi në lidhje me shkallën dhe masën e dëmit presupozon se Trupi Gjykses “[...] i deklaroi parimet sipas të cilave vepron”. Rrjedhimisht, para se të lëshojë urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor, Trupi Gjykses duhet të shtjellojë parimet në lidhje me zhdëmtimet dhe të përcaktojë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen që gjykohet.<sup>48</sup>

30. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se në DHS, sikurse në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) – që ishte juridiksioni penal ndërkombëtar i parë që miratoi sistemin e zhdëmtimeve për viktimat brenda juridiksionit të saj – parashihet një sistem zhdëmtimesh në kontekst të proceseve penale. Trupi Gjykses vë në dukje në këtë aspekt se neni 22 i Ligjit dhe rregulla 168 e Rregullores pasqyrojnë në njëfarë mase formulimet e dispozitave përkatëse për zhdëmtim në tekstet juridike të GJPN-së. Për këtë arsye, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të orientohet nga jurisprudenca e GJPN-së, ndër të tjera edhe për formulimin e parimeve lidhur me zhdëmtimet.<sup>49</sup>

31. Instrumentet e tjera ndërkombëtare, si Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit<sup>50</sup> (“Deklarata e

---

<sup>48</sup> Ngjashëm, KSC-BC-2020-05, F00517, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës* (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), 6 prill 2023, konfidencial, para. 62, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* u lëshua më 14 prill 2023, [F00517/RED/COR](#).

<sup>49</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 63 dhe referencat aty.

<sup>50</sup> United Nations General Assembly, A/RES/40/34, [Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power](#), 29 November 1985.

Parimeve Themelore të Drejtësisë”) dhe Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën për Mjet Juridik dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare<sup>51</sup> (“Parimet Themelore të OKB-së për Zhdëmtimet”) dhe raporte të rëndësishme lidhur me të drejtat e njeriut, gjithashtu ofrojnë orientim për Trupin Gjykses për përcaktimin e parimeve në lidhje me zhdëmtimet.<sup>52</sup>

32. Së fundi, Trupi Gjykses do të orientohet nga jurisprudenca e gjykatave rajonale të të drejtave të njeriut – si Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“GJEDNJ”) dhe Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut (“GJNDNJ”), duke vënë në dukje dallimet midis këtyre gjykatave dhe sistemit të zhdëmtimeve të DHSK-së dhe duke marrë parasysh kontributin e tyre të konsiderueshëm në avancimin e të drejtave të individëve për mjet juridik efektiv dhe për zhdëmtim.<sup>53</sup>

## **B. PARIMET PËR ZHDËMTIMET: PASQYRË E PËRGJITHSHME**

33. Fillimisht, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se mjetet juridike dhe zhdëmtimet për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare janë kusht i domosdoshëm i drejtësisë. Trupi Gjykses gjithashtu dëshiron të theksojë se, sipas mendimit të tij, qëllimi i zhdëmtimeve në DHS nuk është vetëm të ndëshkojë personat e shpallur fajtorë siç parashihet në nenin 44(6) të Ligjit; por shërben për të pranuar dhe për të ndrequr, aq sa është e mundshme, dëmin e shkaktuar viktimës.<sup>54</sup>

<sup>51</sup> United Nations General Assembly, A/RES/40/34, [United Nations Basic Principles on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#), 16 December 2005.

<sup>52</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 64.

<sup>53</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 65.

<sup>54</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 66 dhe referencat aty.

34. Parimet për zhdëmtimet janë koncepte të përgjithshme që së bashku përbëjnë kornizën ligjore që do ta orientojë Trupin Gjykses gjatë përcaktimit të shkallës dhe masës së dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen që gjykohet, të kuadrit të përgjegjësisë së personit të shpallur fajtor për zhdëmtime, dhe të zhdëmtimeve që duhet t'u akordohen viktimave.<sup>55</sup>

35. Si parim i përgjithshëm, zhdëmtimet në DHSK duhet të përqendrohen te viktimat. Kjo do të thotë se interesat, nevojat, pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave duhet të jenë forca shtytëse e procesit të vendimmarrjes për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zhdëmtimet.<sup>56</sup>

36. Në këtë aspekt, DHS-ja u kushton vëmendjen e duhur viktimave dhe i përfshin në mënyrën e duhur në procese në pajtim me nenin 22(11) të Ligjit, për të garantuar respektimin dhe realizimin e të drejtës së tyre për të vërtetën, drejtësi dhe zhdëmtim.<sup>57</sup>

37. Viktimat duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë gjatë të gjithë procesit të zhdëmtimit dhe të marrin mbështetje të mjaftueshme që pjesëmarrja e tyre të jetë thelbësore dhe efektive. Në këtë kontekst, është me shumë rëndësi komunikimi në kohë dhe efektiv që synon informimin e viktimave për zhdëmtimet.<sup>58</sup>

38. Të gjitha viktimat duhet të kenë trajtim të drejtë dhe të barabartë sa u përket zhdëmtimeve. Viktimat duhet të kenë qasje të barabartë në informacion lidhur me të drejtën për zhdëmtim dhe për ndihmë nga DHS-ja.<sup>59</sup> Megjithatë, gjatë vënies në jetë

---

<sup>55</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 67 dhe referencat aty.

<sup>56</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 68 dhe referencat aty.

<sup>57</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 69 dhe referencat aty.

<sup>58</sup> Shih KSC-BC-2020-04, F00064, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Victims' Applications](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), 1 shtator 2021, publik, para. 17. Shih gjithashtu, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 70.

<sup>59</sup> Shih Vendimin Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave ([Victims' Applications Framework Decision](#)), para. 17. Shih gjithashtu, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 71 dhe referencat aty.

dhe zbatimit të dëmshpërblimeve të akorduara nga Trupi Gjykses, mund të nevojitet t'u jepet përparësi viktimave që janë në gjendje veçanërisht të cenueshme ose të cilëve u nevojitet ndihmë urgjente.<sup>60</sup>

39. DHS-ja i trajton viktimat në mënyrë njerëzore, dhe dinjiteti dhe të drejtat njerëzore të tyre duhet të respektohen.<sup>61</sup> Për këtë qëllim, DHSK-ja zbaton masa mbrojtëse të përshtatshme për të garantuar sigurinë e viktimave si dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre,<sup>62</sup> edhe gjatë vënies në jetë dhe zbatimit të urdhrave për zhdëmtim.<sup>63</sup>

40. Komunikimet me viktimat duhet të kryhen me kujdes, duke parandaluar traumatizim të sërishëm dhe duke i menaxhuar me takt pritshmëritë e tyre.<sup>64</sup>

41. Viktimat duhet të marrin zhdëmtime të arsyeshme, të përshtatshme dhe të shpejta. Procesi i zhdëmtimit, përfshirë vënien në jetë dhe zbatimin e urdhrave për zhdëmtim, duhet të jetë sa më i shpejtë që të jetë e mundur dhe duhet të shmangen paditë e zgjatura pa nevojë, komplekse dhe të kushtueshme.<sup>65</sup>

42. Zhdëmtimi duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar, në rrethanat konkrete të çështjes.<sup>66</sup>

---

<sup>60</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 71 dhe referencat aty.

<sup>61</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 72 dhe referencat aty.

<sup>62</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 72 dhe referencat aty. *Shih gjithashtu*, Vendimin Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave ([Victims' Applications Framework Decision](#)), para. 52-53.

<sup>63</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 72 dhe referencat aty.

<sup>64</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 73 dhe referencat aty.

<sup>65</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 74 dhe referencat aty.

<sup>66</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 75 dhe referencat aty.

43. Zhdëmtimi u akordohet viktimave pa dallim seksi, gjinie, moshe, race, ngjyre, gjuhe, feje apo besimi, mendimeve politike apo të tjera, orientimi seksual, origjine kombëtare, etnike apo shoqërore, statusi pasuror, të lindjes, martesor ose tjetër.<sup>67</sup>

44. Për më tepër, në lidhje me zhdëmtimet nuk duhet të përsëriten praktikat apo strukturat diskriminuese që ekzistojnë para kryerjes së krimeve, dhe të cilat pengonin mundësi të barabarta për viktimat. DHS-ja duhet t'i shmangët stigmatizimit të mëtejshëm të viktimave dhe përforcimit të diskriminimit nga familjet dhe komunitetet e tyre. Në veçanti, zhdëmtimet duhet të shmangin krijimin e tensioneve, xhelozisë apo armiqësisë midis komuniteteve të prekura dhe midis grupeve bashkëjetuese.<sup>68</sup>

45. Zhdëmtimet janë vullnetare dhe përpara akordimit të zhdëmtimit nevojitet pëlqimi i marrësit të tij bazuar në informacion.<sup>69</sup>

46. Asnjë nga këto parime nuk duhet të cenohet apo të jetë në mospajtim me të drejtat e personit të akuzuar ose të shpallur fajtor për procedim të drejtë dhe të shpejtë. Për më tepër, personit të akuzuar ose të shpallur fajtor, sipas rastit, duhet t'i jepet kohë dhe mundësi të përgjigjet dhe/ose të bëjë parashtrime në lidhje me zhdëmtimet.<sup>70</sup>

47. Gjatë të gjithë fazave të zhdëmtimit dhe veçanërisht gjatë vënies në jetë dhe zbatimit të urdhrave për zhdëmtim, të gjithë subjektet dhe personat në Kosovë janë të detyruar të bashkëpunojnë plotësisht me DHS-në.<sup>71</sup>

---

<sup>67</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 76 dhe referencat aty.

<sup>68</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 77 dhe referencat aty.

<sup>69</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 78 dhe referencat aty.

<sup>70</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 79 dhe referencat aty.

<sup>71</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 80 dhe referencat aty.

48. Së fundi, zhdëmtimet e akorduara në përputhje me urdhrin për zhdëmtim nuk e lirojnë Kosovën nga detyrimet e saj, sipas legjislacionit vendor ose traktateve ndërkombëtare, që t'i dëmshpërblejë qytetarët e vet.<sup>72</sup>

### C. PËRFITUESIT E ZHDËMTIMEVE

49. Trupi Gjykses vë në dukje se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që viktimat të pranohen në procese në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit.<sup>73</sup> Trupi Gjykses nuk sheh arsye për të devijuar nga kjo jurisprudencë në kontekstin e zhdëmtimit, duke vënë në dukje, sidoqoftë, standardin e ndryshëm të vërtetimit në lidhje me zhdëmtimin që duhet të përmbushet nga viktimat.<sup>74</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i përfshin dispozitat ligjore përkatëse dhe kriteret e përcaktuara më parë përmes referimit dhe do t'i diskutojë vetëm shkurtimisht këtu.<sup>75</sup>

50. Që të kenë të drejtë për zhdëmtim, viktimat duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- i. viktima është person fizik;
- ii. krimi që ka shkaktuar dëmin duhet të jetë krim për të cilin personi është shpallur fajtor;
- iii. viktima ka pësuar dëm personalisht; dhe

---

<sup>72</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 81 dhe referencat aty.

<sup>73</sup> [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 34, 36, 38-45. Shih gjithashtu, Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([First Decision on Victims' Participation](#)), para. 26-33.

<sup>74</sup> Shih para. 67 dhe në vijim më poshtë..

<sup>75</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 82 dhe referencat aty.



iv. dëmi ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i krimit për të cilin personi është shpallur fajtor.<sup>76</sup>

51. Rrjedhimisht, viktimat duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si ato për t'u pranuar në proces gjyqësor, por vetëm se dëmi i pësuar është rezultat i "i krimit për të cilin personi është shpallur fajtor" në vend të krimit në aktakuzën e konfirmuar.<sup>77</sup>

52. Sa i përket aspektit që dëmi duhet të jetë pësuar personalisht nga viktima, Trupi Gjykes rikujton se kjo nënkupton kushtin që dëmi të jetë pësuar nga viktima, d.m.th është dëmtuar mirëqenia fizike apo mendore ose gjendja ekonomike e tij ose e saj. Kjo mund të përfshijë dëmin e pësuar nga viktimat që ishin objekt i veprimeve të kryesit (kryesve) (viktimat e drejtpërdrejta).<sup>78</sup>

53. Dëmi i pësuar nga një viktimë si rezultat i një apo më shumë krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor mund t'u shkaktojë dëm viktimave të tjera. Këtu mund të përfshihet dëmi i pësuar nga persona në marrëdhënie të ngushtë personale me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë apo të lënduar nga kryesit (viktimat e tërthorta).<sup>79</sup> Anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) konsiderohet se janë në marrëdhënie të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë.<sup>80</sup>

54. Trupi Gjykes dëshiron të theksojë se vërtetimi i "marrëdhënies së ngushtë personale" me viktimën e drejtpërdrejtë është një mënyrë se si viktimat e tërthorta

---

<sup>76</sup> Në kuadër të Urdhrit për Zhdëmtim, do të merren parasysh vetëm viktimat e pranuar për pjesëmarrje në proces. *Shih, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 83.

<sup>77</sup> *Shih Vendimin Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave (Victims' Applications Framework Decision)*, para. 34(b) dhe (d). *Shih gjithashtu, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 84 dhe referencat aty.

<sup>78</sup> *Shih Vendimin Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave (Victims' Applications Framework Decision)*, para. 40. *Shih, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 85 dhe referencat aty.

<sup>79</sup> *Shih Vendimin Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave (Victims' Applications Framework Decision)*, para. 40. *Shih, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 86 dhe referencat aty.

<sup>80</sup> *Shih Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (First Decision on Victims' Participation)*, para. 28 dhe referencat aty. *Shih gjithashtu, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 86 dhe referencat aty.

mund të provojnë se kanë pësuar dëm personal dhe se dëmi është rezultat i krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor. Trupi Gjykues gjithashtu vlerëson se ndër viktimat e tërthorta mund të përfshihen ata që kanë pësuar dëm kur kanë ndërhyrë për të ndihmuar viktimat në fatkeqësi ose për të parandaluar viktimizimin.<sup>81</sup>

55. Në rast se viktimat për të cilën është konstatuar se gëzon të drejtën për zhdëmtim vdes para se t'i akordohet zhdëmtimi, pasardhësit ose trashëguesit e viktimës kanë të njëjtën të drejtë për zhdëmtimin e akorduar.<sup>82</sup>

## D. DËMI

### 1. Koncepti dhe llojet e dëmit

56. Koncepti i dëmit përfshin “çdo dëmtim, humbje dhe lëndim”.<sup>83</sup>

57. Ligji dhe Rregullorja identifikojnë tri lloje të dëmit: fizik, mendor dhe material.<sup>84</sup> Sa u përket llojeve të dëmit, Trupi Gjykues përfshin përmes referimit përkufizimet e përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake<sup>85</sup> dhe do t'i zgjerojë ato vetëm nëse vlerësohet se është e nevojshme.

58. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues dëshiron të theksojë se viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare, si tortura, shpesh vuajnë pasoja afatgjata përtej dëmit të atypëratyshëm fizik, mendor ose material. Kjo shfaqet me mundësi të humbura, përfshirë në lidhje me punësimin,

---

<sup>81</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 87 dhe referencat aty.

<sup>82</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 88 dhe referencat aty.

<sup>83</sup> Shih nenin 22(7) të Ligjit.

<sup>84</sup> Neni 22(1) i Ligjit; rregulla 2 e Rregullores; [First Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 29 dhe referencat aty. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 90 dhe referencat aty.

<sup>85</sup> [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 41-43.

arsimimin, dhe përfitimet shoqërore.<sup>86</sup> Trupi Gjykses rikujton gjithashtu konstatimin e tij të mëparshëm në Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* në lidhje me konceptin se dëmi i shkaktuar ndaj planeve ose projekteve për jetën, nënkupton faktin se jeta e viktimës dhe/ose e anëtarëve të familjes ndërpritet ose çrregullohet si rezultat i krimeve të kryera kundër tyre. Më konkretisht, kjo ka të bëjë me mungesën e vetërealizimit të plotë të një personi, i cili, duke pasur parasysh profesionin, aftësitë, rrethanat, potencialin dhe aspiratat, logjikisht mund të priste të arrinte gjëra të caktuara në jetë. Kjo shprehet përmes pritshmërive për zhvillim personal, profesional dhe familjar që janë të mundshme në rrethana normale. Ky dëm nënkupton humbje ose pakësim të madh të mundësive për zhvillim, në mënyrë të riparueshme, ose të riparueshme me shumë vështirësi.<sup>87</sup>

59. Trupi Gjykses gjithashtu mendon se dëmi mund të shtrihet mbi disa breza, *d.m.th.* kur dhuna shoqërore përcillet nga paraardhësit te pasardhësit me pasoja traumatike për të dytët.<sup>88</sup>

## 2. Shkakësia

60. Trupi Gjykses kujton se, në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 të Rregullores, “viktima është person fizik që personalisht ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, mendor ose material, si *rezultat i drejtpërdrejtë* i krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara” [theksimi i shtuar]. Trupi Gjykses vë në dukje se as Ligji e as Rregullorja nuk i përkufizojnë kushtet e sakta të lidhjes shkakësore midis krimit dhe dëmit përkatës në kontekstin e zhdëmtimit.<sup>89</sup>

<sup>86</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 91 dhe referencat aty. Shih gjithashtu, ICC, *Prosecutor v Ongwen*, ICC-02/04-01/15-2074, Trial Chamber IX, [Reparations Order](#), 28 February 2024, para. 168 dhe referencat aty.

<sup>87</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 91 dhe referencat aty.

<sup>88</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 92 dhe referencat aty. Shih gjithashtu, në lidhje me dëmin e shkaktuar disa brezave, [Ongwen Reparations Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Ongwen*), para. 168 në vijim.

<sup>89</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 93.

61. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, lidhja shkakësore midis krimit dhe dëmit në kontekstin e zhdëmtimit duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrethanat konkrete të çështjes.<sup>90</sup>

62. Sa i përket shkakësisë faktike, në përcaktimin e lidhjes midis krimit dhe dëmit Trupi Gjykses zbaton standardin “sikur të mos ishte”, që do të thotë se, sikur të mos ishte kryer krimi (krimet) nga personi i shpallur fajtor, dëmi nuk do të kishte ndodhur.<sup>91</sup>

63. Sa i përket shkakut të drejtpërdrejtë ose shkakut juridik, Trupi Gjykses mbështet përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në kontekstin e pjesëmarrjes së viktimave, konkretisht se dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i krimit:

kur, në rrethanat që kanë ekzistuar në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë parasysh gjendjen personale të viktimës, kishte shumë të ngjarë që veprimet ose mosveprimet e kryesit ose kryesve ta shkaktonin atë dëm, nga këndvështrimi i një vëzhguesi objektiv.<sup>92</sup>

64. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se nuk është kusht që krimi të jetë i vetmi shkak i dëmit të pësuar, por duhet të ketë kontribuar në të.<sup>93</sup>

65. Sa u përket viktimave të tërthorta, parashtruesit e kërkesave duhet të tregojnë se dëmi i pësuar prej tyre ishte rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë.<sup>94</sup> Megjithatë, për dëmin mendor, prezumohet vuajtja shpirtërore (si dhimbja, hidhërimi,

<sup>90</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 94 dhe referencat aty.

<sup>91</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 95 dhe referencat aty.

<sup>92</sup> [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave) para. 45. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 96 dhe referencat aty.

<sup>93</sup> Trupi Gjykses nuk pajtohet me përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se krimi duhet të ketë kontribuar në masë të *konsiderueshme* për dëmin (shih [First Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 33. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 97 dhe referencat aty.

<sup>94</sup> [First Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 30-33 dhe referencat aty. Shih para. 53-54 më lart. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 98 dhe referencat aty. [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 37 dhe referencat aty. Shih para. 53-54 më lart.

pikëllimi i thellë, ose shqetësimi) e viktimës së tërthortë si rezultat i vdekjes ose lëndimit të rëndë të viktimës së drejtpërdrejtë, me kusht që të vërtetohet mjaftueshëm lidhja e ngushtë midis tyre.<sup>95</sup>

### 3. Detyrimi dhe standardi i vërtetimit

66. Viktimat që kërkojnë zhdëmtim duhet të paraqesin prova të mjaftueshme për: identitetin e tyre si persona fizikë; shkallën dhe masën e dëmit të pësuar; dhe për lidhjen shkakësore midis krimit për të cilin është dhënë vendim fajësie dhe dëmit të pësuar.<sup>96</sup>

67. Ndryshe nga kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e viktimave në procese gjyqësore,<sup>97</sup> Ligji dhe Rregullorja nuk saktësojnë standardin e vërtetimit në lidhje me zhdëmtimet. Sipas mendimit të Trupit Gjyqësor, përcaktimi i standardit të “përshtatshëm”, dhe se çfarë është “e mjaftueshme” për përmbushjen e detyrimit të vërtetimit, do të varet nga rrethanat konkrete të çështjes.<sup>98</sup>

68. Në lidhje me këtë, duke marrë parasysh se procedurat për zhdëmtimet janë themelësisht të ndryshme nga gjykimet ku fajësia e të akuzuarit duhet të provohet jashtë dyshimit të arsyeshëm, për to duhet të zbatohet një standard vërtetimi më pak rigoroz se ai që zbatohet gjatë gjykimet.<sup>99</sup> Gjithashtu, Trupi Gjyqësor është i mendimit se standardi i vërtetimit “*prima facie*”<sup>100</sup> i zbatuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjyqësor, sipas rastit, për vlerësimin e informacionit dhe materialit

<sup>95</sup> [First Decision on Victims’ Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 31. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 98 dhe referencat aty. Që ka të bëjë me “marrëdhënien e ngushtë personale”, shih para. 53 më lart.

<sup>96</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 99.

<sup>97</sup> Shih rregullën 113(4) të Rregullores.

<sup>98</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 100.

<sup>99</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 101 dhe referencat aty.

<sup>100</sup> Shih rregullën 113(4) të Rregullores. “*Prima facie*” do të thotë “në shikim të parë; në dukje; siç duket në shikim të parë pa hetime” ([Victims’ Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 35 dhe referencat aty). Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 101 dhe referencat aty.

mbështetës të paraqitur nga individët për pjesëmarrje në procese gjyqësore, nuk është i përshtatshëm, duke pasur parasysh detyrimet e personit të shpallur fajtor që burojnë nga urdhri për zhdëmtim.

69. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh praktikën e GJPN-së, Trupi Gjykses përdor kriterin e “tërësisë së gjasave” si standard të përshtatshëm të vërtetimit në kontekstin e zhdëmtimeve. Ky standard vërtetimi do të thotë që viktima duhet të provojë se ka më shumë të ngjarë që ai ose ajo të ketë pësuar dëm si pasojë e njërit prej krimeve për të cilat z. Shala është shpallur fajtor.<sup>101</sup>

70. Për më tepër, Trupi Gjykses është i mendimit se dëme të caktuara mund të prezumohen kur viktima ka demonstruar, bazuar në tërësinë e gjasave, se është viktimë e krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor, dhe se mund të mbështetet në prova rrethore kur viktima nuk ka prova të drejtpërdrejt. Sidoqoftë, kur mbështetet në prezumim, Trupi Gjykses duhet të respektojë si të drejtat e viktimave, ashtu edhe ato të personit të shpallur fajtor.<sup>102</sup>

#### E. LLOJET DHE MODALITETET E ZHDËMTIMEVE<sup>103</sup>

71. Në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullën 168(1) të Rregullores, viktimave mund t’u akordohen zhdëmtime “kolektivisht ose individualisht”. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, këto dy lloje zhdëmtimesh nuk përjashtojnë njëri-tjetrin dhe mund të akordohen njëkohësisht.<sup>104</sup>

---

<sup>101</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 102 dhe referencat aty.

<sup>102</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 103 dhe referencat aty.

<sup>103</sup> Sa i përket dallimit midis “llojeve” dhe “modaliteteve” të zhdëmtimit, shih ICC, *Prosecutor v Katanga*, ICC-01/04-01/07-3728-tENG, Trial Chamber II, [Order for Reparations pursuant to Article 75 of the Statute](#), 24 mars 2017 (English translation filed on 17 August 2017), publik, para. 265-295 (për llojet), 296-305 (për modalitetet), me Shtojcën I, publike dhe Shtojcën II, konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>104</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 104 dhe referencat aty.

72. Zhdëmtimet mund të përshkruhen si individuale kur dëmshpërblimi rezultues i jepet drejtpërdrejt viktimës për të ndrequr dëmin e pësuar si pasojë e krimeve për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari; ato i japin viktimës një dëmshpërblim për të cilin ai ose ajo ka të drejtë ekskluzive. Zhdëmtimet individuale duhet të akordohen në mënyrë të tillë që të shmangin krijimin ose shtimin e tensioneve dhe ndasive në komunitetet përkatëse.<sup>105</sup>

73. Termi zhdëmtime kolektive mund t'u referohet karakterit të tyre (llojit të mallrave ose shërbimeve që shpërndahen ose mënyrës së shpërndarjes), ose përfituesve të tyre (komuniteteve ose grupeve). Ato dallojnë nga zhdëmtimet individuale për faktin se përfitues të tyre janë grupi ose kategoria e personave që kanë pësuar dëm bashkërisht. Zhdëmtimet kolektive mund të mbulojnë dëmin e pësuar nga viktimat qoftë individualisht apo kolektivisht.<sup>106</sup>

74. Neni 44(6) i Ligjit përcakton vetëm dy modalitete të zhdëmtimeve, gjegjësisht dëmshpërblim dhe kompensim. Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet në Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* se Parimet Themelore të OKB-së për Zhdëmtimet përcaktojnë dy modalitete shtesë për zhdëmtimet, konkretisht rehabilitimin dhe njohjen,<sup>107</sup> të cilat janë të zbatueshme edhe në DHS.<sup>108</sup>

75. Zhdëmtimet mund të kenë gjithashtu vlerë simbolike, parandaluese dhe transformuese, dhe mund të ndihmojnë në promovimin e pajtimit midis viktimave të krimeve, komuniteteve të prekura dhe personit të shpallur fajtor.<sup>109</sup>

---

<sup>105</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 105 dhe referencat aty.

<sup>106</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 106 dhe referencat aty.

<sup>107</sup> *Shih* [UN Basic Principles on Reparations](#), para. 18-22.

<sup>108</sup> *Shih* Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 107 dhe referencat aty.

<sup>109</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 108 dhe referencat aty.

76. Kthimi i të drejtave përkufizohet si masa që synojnë ta rikthejnë, aq sa është e mundshme, jetën e viktimës ashtu si ka qenë para shkeljeve, përfshirë kthimin në familje, në shtëpi, në punën e mëparshme, vazhdimin e arsimit, ose kthimin e pasurisë së humbur apo të vjedhur. Ky modalitet i zhdëmtimeve mund të mos jetë gjithmonë i mjaftueshëm ose i përshtatshëm.<sup>110</sup>

77. Kompensimi zakonisht është akordim i fondeve monetare si pagesë për dëmet e pësuarat. Në raste të caktuara, ai merr formën e “masës ndreqëse zëvendësuese” pasi nuk mund të kthejë anëtarin e familjes që është vrarë ose t’i rikthejë aftësitë fizike personit që është lënduar. Kjo vlen si për dëmet financiare ashtu edhe për ato jofinanciare.<sup>111</sup>

78. Masat e rehabilitimit mund të përfshijnë kujdesin mjekësor, zhvillimin ekonomik, ndihmën sociale apo shërbimet juridike.<sup>112</sup>

79. Njohja mund të përfshijë masa të cilat njohin shkeljet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ose shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Ajo mund të përfshijë, për shembull, kërkimin publikisht të faljes nga kryesit e dhunës, së bashku me pranimin e fakteve dhe pranimin e përgjegjësisë, zbulimin e plotë dhe publik të së vërtetës, me kusht që të mos shkaktojë sërish dëm për viktimat dhe familjet e tyre, të mos kërcënojë sigurinë e dëshmitarëve dhe viktimave ose përkujtimin dhe respektin për viktimat.<sup>113</sup>

---

<sup>110</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 109 dhe referencat aty.

<sup>111</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 110 dhe referencat aty.

<sup>112</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 111 dhe referencat aty.

<sup>113</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 112 dhe referencat aty.



## F. PËRGJEGJËSIA E PERSONIT TË SHPALLUR FAJTOR PËR ZHDËMTIM

80. Zhdëmtimet në DHS duhet të pasqyrojnë kontekstin prej të cilit burojnë, domethënë sistemin juridik sipas të cilit është vërtetuar përgjegjësia penale individuale për krime sipas Ligjit. Rrjedhimisht, urdhri për zhdëmtim duhet të jepet vetëm në lidhje me krimet për të cilat është vendosur se ka përgjegjësi personi i shpallur fajtor, dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat kundër personit të shpallur fajtor.<sup>114</sup>

81. Përgjegjësia për zhdëmtim e personit të shpallur fajtor duhet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar, në rrethanat konkrete të çështjes.<sup>115</sup>

82. Në përcaktimin e shumës së zhdëmtimit për të cilën është përgjegjës personi i shpallur fajtor, faktori kryesor duhet të jetë shkalla dhe masa e dëmit të pësuar nga viktimat.<sup>116</sup>

83. Përgjegjësia e personave, organizatave të tjera, ose e shtetit, nuk është relevante për përcaktimin e përgjegjësisë për zhdëmtim që ka personi i shpallur fajtor.<sup>117</sup>

84. Gjithashtu, mungesa e mjeteve financiare e personit të shpallur fajtor nuk është relevante për përcaktimin e lartpërmendur. Faktikisht, mungesa e mjeteve financiare e personit të shpallur fajtor në kohën e lëshimit të urdhrit për zhdëmtim nuk është pengesë për përcaktimin e përgjegjësisë për zhdëmtim, e as nuk i jep personit të shpallur fajtor të drejtën për zvogëlim të kësaj përgjegjësie. Në fakt, urdhri për zhdëmtim mund të zbatohet kundër personit të shpallur fajtor kur monitorimi i gjendjes financiare tregon se personi i ka mjetet për përmbushjen e urdhrit. Megjithëse

---

<sup>114</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 113 dhe referencat aty.

<sup>115</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 114 dhe referencat aty.

<sup>116</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 115 dhe referencat aty.

<sup>117</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 116 dhe referencat aty.

rrethanat financiare të personit të shpallur fajtor mund të ndikojnë në mënyrën në të cilën vihen në jetë dhe zbatohen zhdëmtimet, zbatimi përbën aspekt më vete që shkon përtej përcaktimit të përgjegjësisë për zhdëmtime të personit të shpallur fajtor.<sup>118</sup>

#### IV. PROVAT E ADMINISTRUARA PREJ TRUPIT GJYKUES DHE METODOLOGJIA E TRUPIT GJYKUES PËR VLERËSIMIN E KËRKESËS PËR ZHDËMTIME

85. Gjatë vlerësimit nëse viktimat kanë vërtetuar se ekziston dëmi i pretenduar dhe lidhja shkakësore midis dëmit dhe krimeve për të cilat z. Shala është shpallur fajtor, Trupi Gjykses do të shqyrtojë: (i) Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim në emër të parashtruesve të kërkesave; (ii) vendimet me të cilat parashtruesit u pranuan si viktimat pjesëmarrëse;<sup>119</sup> (iii) dëshmitë e parashtruesve para Trupit Gjykses;<sup>120</sup> (iv) Deklaratën mbi Pasojat; (v) Aktekspertizat e iMMO-së; (vi) Raportin *Lerc*, dhe (vii) Aktekspertizën e Mbrojtjes.

86. Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se konstatimet faktike dhe ligjore në Aktgjykim të cilat çuan në shpalljen fajtor dhe dënimin e z. Shala, janë detyruese për të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të bazohet në çdo konstatim relevant në Aktgjykim, përfshirë në lidhje me besueshmërinë ose mbështetshmërinë. Trupi Gjykses nuk do të bazohet në informacion apo material mbështetës që qartësisht nuk është autentik.<sup>121</sup>

---

<sup>118</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 117 dhe referencat aty.

<sup>119</sup> *Shih* Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([First Decision on Victims' Participation](#)); Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Decision on Victims' Participation](#)); dhe Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Decision on Victims' Participation](#)).

<sup>120</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se pesë (5) parashtrues të kërkesave kanë status të dyfishtë si viktimat pjesëmarrëse dhe dëshmitarë, dhe të pestë dëshmuar në gjykim.

<sup>121</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 119-120 dhe referencat aty.

87. Në lidhje me aktekspertizat, Trupi Gjykses merr parasysh faktorë si kompetenca e ekspertëve në fushën e tyre të ekspertizës, metodologjitë e përdorura, sa përpunohen konstatimet me provat e tjera, dhe mbështetshmërinë e përgjithshme në dëshmitë e ekspertëve.<sup>122</sup>

88. Vlerësimi prej Trupit Gjykses i kërkesës për zhdëmtim sipas këtyre kriterëve kryhet duke u bazuar në tërësinë e gjasave, duke pasur parasysh koherencën e brendshme të kërkesës në tërësi, përfshirë dokumentacionin mbështetës, konstatimet relevante në Aktgjykim dhe të gjitha rrethanat përkatëse.<sup>123</sup>

89. Trupi Gjykses do të marrë parasysh çdo vështirësi me të cilën mund të jenë ballafaquar viktimat gjatë mbledhjes dhe dorëzimit të informacionit – si të të dhënave mjekësore, financiare dhe të punësimit – ndër të tjera edhe për shkak të kalimit të kohës që nga kryerja e krimeve.<sup>124</sup> Trupi Gjykses gjithashtu do të marrë parasysh faktin që viktimat mund të mos u kenë treguar të tjerëve çfarë përjetuan në FMK, ndër të tjera edhe për shkak të atmosferës së frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër personave që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se janë kryer nga ish-anëtarë të UÇK-së.<sup>125</sup> Në mungesë të dokumentacionit, rrëfimi koherent dhe i besueshëm i viktimës mund të pranohet si provë e mjaftueshme në mbështetje të kërkesës për zhdëmtim, në bazë të tërësisë së gjasave.<sup>126</sup>

90. Gjithashtu, kur ta gjykojë të përshtatshme, Trupi Gjykses do të mbështetet në prezumime, kur viktimat të ketë provuar, në bazë të tërësisë së gjasave, se është

<sup>122</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 88. Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 120 dhe referencat aty.

<sup>123</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 121 dhe referencat aty; shih gjithashtu, edhe pse zbatohet një standard tjetër vërtetimi, [First Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 25 dhe referencat aty.

<sup>124</sup> Shih para. 67 më lart; ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 122 dhe referencat aty.

<sup>125</sup> Shih Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 96-97 dhe referencat aty.

<sup>126</sup> Ngjashëm, [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 90 ("Në përpunime me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të vlerësojë nëse një provë e vetme, apo disa prova të marra së bashku, mjaftojnë për vërtetimin e një fakti specifik"). Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa), para. 122 dhe referencat aty.

viktimë e krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor, ose do të mbështetet në provat rrethanore.<sup>127</sup>

## V. SHKALLA DHE MASA E DËMIT

### A. PARASHTRIMET

91. **Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave.** Mbrojtësi i Viktimave parashtrio kërkesë për zhdëmtim në emër të viktimave.<sup>128</sup>

92. Në lidhje me V01/04-ën, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se ai pësoi dëm si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të kryera nga z. Shala, [REDAKTUAR].<sup>129</sup> Sipas Mbrojtësit të Viktimave, dëmi që pësoi V01/04 në FMK si rezultat i keqtrajtimit të [REDAKTUAR] atij [REDAKTUAR] duhet të kuptohet në tërësinë e dëmit dhe elementet përbërëse të tij nuk mund të merren më vete.<sup>130</sup> Mbrojtësi i Viktimave argumenton se V01/04 pësoi dëm të konsiderueshëm fizik dhe mendor, si dhe dëm material si rezultat i krimeve të kryera nga z. Shala [REDAKTUAR].<sup>131</sup>

93. Në lidhje me V02/04-ën, V03/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe V08/04-ën, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se, si viktimi të tërthorta, ata të gjithë vuajtën nga dëmi afatgjatë mendor dhe material si rezultat i krimeve të luftës të

---

<sup>127</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 123.

<sup>128</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 18-58.

<sup>129</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 18-34.

<sup>130</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 18.

<sup>131</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 20-22 (në lidhje me dëmin fizik), 23-30 (në lidhje me dëmin mendor) dhe 31-34 (në lidhje me dëmin material); Deklarata mbi Pasojat, para. 38-102.

ndalimit arbitrar dhe torturës të kryera nga z. Shala kundër anëtarit të familjes së tyre.<sup>132</sup>

94. **Përgjigjja e Mbrojtjes.** Në përgjigjen e saj, Mbrojtja argumenton se Mbrojtësi i Viktimave nuk ka identifikuar shkallën dhe masën e dëmit fizik të pësuar sa i përket V01/04-ës.<sup>133</sup> Në lidhje me V02/04-ën, V03/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe V08/04-ën, Mbrojtja parashtron se Mbrojtësi i Viktimave nuk ka paraqitur prova për dëmin material sipas standardit të kërkuar.<sup>134</sup> Mbrojtja parashtron gjithashtu se dëmi fizik dhe mendor që pësuan viktimat nuk është shkaktuar drejtpërdrejt nga krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor, sepse z. Shala nuk i ka kryer veprimet që shkaktuan dëmin.<sup>135</sup> Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes, z. Shala nuk mund të mbajë përgjegjësi për të riparuar dëmin material që pësuan viktimat.<sup>136</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykses të hedhë poshtë Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim dhe të mos lëshojë urdhrin për zhdëmtim.<sup>137</sup>

95. Në pjesën në vijim, Trupi Gjykses do të analizojë Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim për të përcaktuar shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat.

## B. IDENTITETI SI PERSON FIZIK

96. Fillimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se viktimat u pranuan në procesin gjyqësor si viktima pjesëmarrëse dhe, në këtë kontekst, dorëzuan dokumentacion zyrtar mbështetës lidhur me identitetet e tyre si persona fizikë.<sup>138</sup> Pas shqyrtimit të

---

<sup>132</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 35-47, 48-55; Deklarata mbi Pasojat, para. 103-183.

<sup>133</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 29.

<sup>134</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 59-61.

<sup>135</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 20-21, 32-44, 48-55, 64.

<sup>136</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 44 dhe 61.

<sup>137</sup> Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 6, 68.

<sup>138</sup> [First Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 26 dhe referencat aty (në lidhje me V01/04-ën); [Second Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Dytë mbi

dokumentacionit mbështetës, të paraqitur në kërkesën për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, sipas standardit të kërkuar në këtë fazë të procesit, Trupi Gjykses konstaton se çdo viktimë ka vërtetuar në bazë të tërësisë së gjasave se është person fizik.<sup>139</sup>

## C. DËMI I PËSUAR NGA VIKTIMAT

### 1. Aspekte paraprake

97. Para se të vijojë më tutje, Trupi Gjykses e gjykon të nevojshme të trajtojë dy argumente të Mbrojtjes në përgjigje ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave, sepse ato kanë të bëjnë me të gjitha viktimat në këtë çështje gjyqësore.

98. Së pari, sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se Mbrojtësi i Viktimave nuk ka identifikuar shkallën dhe masën e dëmit fizik të pësuar, Trupi Gjykses rikujton se viktimat e pretenduara duhet të japin hollësi, për aq sa është e mundshme për llojin, sa i rëndë është lëndimi, pjesën e trupit dhe numrin e lëndimeve, si dhe pasojat e tyre mbi shëndetin, aftësinë për të punuar dhe mirëqenien e viktimës.<sup>140</sup> Si dëshmi të dëmit fizik, viktimat e pretenduara mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, certifikata mjekësore, receta për barna, fotografi ose dokumentacion tjetër si dëshmi të lëndimeve trupore.<sup>141</sup> Sidoqoftë, nga viktimat nuk kërkohet që të evidentojnë secilin lëndim të pësuar gjatë keqtrajtimit veç e veç, as të identifikojnë secilin person që

---

Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 25 dhe referencat aty, (në lidhje me V02/04-ën) dhe [Third Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 28 dhe referencat aty (në lidhje me V03/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe V08/04-ën).

<sup>139</sup> Ngjashëm, [Mustafa Reparation Order](#) (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 130 dhe referencat aty. Trupi Gjykses vë në dukje se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vendosur tashmë në lidhje me këtë, edhe pse bazuar në një standard më pak rigoroz. Trupi Gjykses rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses, sipas rastit, vlerëson prima facie informacionin dhe materialin mbështetës të dorëzuar nga persona që synojnë të marrin pjesë në proces (shih rregullën 113(4)), që do të thotë “në shikim të parë; në dukje; siç duket në shikim të parë pa hetime”; shih, ngjashëm, [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 35 dhe referencat aty.

<sup>140</sup> [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 41.

<sup>141</sup> [Victims' Applications Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave), para. 41.

shkaktuan ato, me kusht që dëmi të ketë rezultuar nga krimet për të cilat z. Shala është shpallur fajtor. Duke pasur parasysh Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim dhe Deklaratën mbi Pasojat, si dhe konstatimet e bëra jashtë dyshimit të arsyeshëm në Aktgjykim, Trupi Gjykses konstaton se shkalla dhe masa e dëmit të pretenduar është paraqitur në hollësi të mjaftueshme në Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ky argument i Mbrojtjes është i pabazë.

99. Së dyti, sa i përket argumentit të Mbrojtjes se krimet të cilat rezultuan në vuajtjet e viktimave nuk janë veprime që kreu z. Shala, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja keqinterpreton krejtësisht standardin e lidhjes shkak-pasojë. Lidhja shkak-pasojë duhet të përcaktohet midis krimeve për të cilat z. Shala është shpallur fajtor dhe dëmin e pretenduar të pësuar nga viktimat.<sup>142</sup> Detyrimi i z. Shala për të riparuar dëmin buron nga përgjegjësia penale individuale e tij si anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke qenë se kreu krimet e lartpërmendura, sikurse është vërtetuar në Aktgjykim.<sup>143</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje se, në fakt, z. Shala mori pjesë aktive në disa prej rrahjeve, dhe rrjedhimisht mori pjesë drejtpërdrejt edhe në dëmin që pësuan viktimat.<sup>144</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se nuk është me rëndësi nëse ai personalisht kreu veprimet individuale që rezultuan në dëmin në fjalë, as nuk është e nevojshme, e as e mundur, të bëhet lidhja midis secilit dëm konkret me secilën ngjarje konkrete të keqtrajtimit. Kjo vlen veçanërisht në rastin kur viktimat janë keqtrajtuar sistematikisht në mënyra të ndryshme për disa javë, përfshirë kushtet çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit.<sup>145</sup> Sikurse do të shtjellohet në hollësi më poshtë, Trupi Gjykses është bindur se ka prova të mjaftueshme se dëmi që pësuan

---

<sup>142</sup> *Shih, ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Ntaganda, ICC-01/04-02/06-2659, Trial Chamber VI, [Reparations Order](#), 8 mars 2021, para. 31, 75-76.*

<sup>143</sup> *Shih, në veçanti, Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 994, 1007, 1037-1039.*

<sup>144</sup> *Shih, në veçanti, Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 1014, 1017, 1025 and 1028.*

<sup>145</sup> Në lidhje me keqtrajtimin sistematik të të ndaluarve në FMK, *shih Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 1015 and 1022.*

viktimat në këtë çështje gjyqësore buron nga krimet për të cilat z. Shala është shpallur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes në lidhje me këtë.

## 2. Dëmi i pësuar nga V01/04 [REDAKTUAR]

100. **Reflektime paraprake.** Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar jashtë dyshimit të arsyeshëm: (i) se V01/04 [REDAKTUAR] në mënyrë arbitrare dhe [REDAKTUAR] në FMK nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala;<sup>146</sup> dhe (ii) se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq në ndalim në FMK, nga pasojat e plagës me armë zjarri në këmbë që iu shkaktua gjatë një marrjeje në pyetje, shoqëruar me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.<sup>147</sup>

101. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimin e Mbrojtësit të Viktimave se është e vështirë të bëhet dallimi midis dëmit që pësoi V01/04 [REDAKTUAR].<sup>148</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses e sheh të përshtatshme të diskutojë, për as sa është e mundshme, dëmin që pësoi V01/04 [REDAKTUAR], duke pranuar se [REDAKTUAR] disa lloje të dëmit (p.sh. dëmi fizik).

102. Për vlerësimin e dëmit fizik dhe mendor, Trupi Gjykses mbështetet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, dëshminë e V01/04-ës para Trupit Gjykses, si dhe dëshmitë e ekspertëve dhe aktekspertizat e tyre.<sup>149</sup> Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar se V01/04 është i besueshëm dhe mund të mbështetesh në dëshminë e tij dhe Trupi Gjykses u mbështet në dëshminë e tij në Aktgjykim.<sup>150</sup> Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se dëshmitarët ekspertë znj. Duhne-Prinsen, dr. Lozano Parra [REDAKTUAR] ishin tejet të besueshëm dhe u mbështet në dëshmitë e tyre në

---

<sup>146</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 368-414, 654-688.

<sup>147</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR].

<sup>148</sup> ([Victims' Counsel Reparations Request](#)) Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 18.

<sup>149</sup> *Shih* Aktekspertizën e iMMO-së; dëshmitë e znj. **Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra**: T. 21 gusht 2023, konfidenciale, f. 2251-2333; [REDAKTUAR].

<sup>150</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 98-119.



Aktgjykim.<sup>151</sup> Së fundi, në lidhje me dëmin material, Trupi Gjykses do t'u referohet konstatimeve në Aktekspertizën *Lerc* dhe Aktekspertizën e Mbrojtjes, nëse është e nevojshme.

103. **Dëmi fizik.** V01/04 u mbajt i ndaluar në mënyrë arbitrare afërsisht [REDAKTUAR] në FMK.<sup>152</sup> Gjatë kësaj kohe, ai u bë objekt i keqtrajtimit të rëndë, përfshirë rrahjen, ngacmimin dhe poshtërimin nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala.<sup>153</sup> V01/04 u godit, ndër të tjera, me shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe shkopinj gome dhe – në të paktën në një rast – me armë zjarri.<sup>154</sup> Ai u keqtrajtua me orë të tëra, dhe ndonjëherë deri sa humbi ndjenjat.<sup>155</sup> [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].<sup>156</sup> Në një rast, [REDAKTUAR].<sup>157</sup> Në një rast tjetër, [REDAKTUAR].<sup>158</sup> Z. Shala ishte i pranishëm dhe mori pjesë në keqtrajtimin e V01/04-ës [REDAKTUAR].<sup>159</sup> Krahas keqtrajtimit të pësuar gjatë ndalimit, V01/04 [REDAKTUAR], sikurse të ndaluarit e tjerë në FMK, [REDAKTUAR] nënshtruan kushteve çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit.<sup>160</sup>

104. Si pasojë e kushteve të ndalimit, V01/04 humbi shumë peshë.<sup>161</sup> Si rezultat i keqtrajtimit të rëndë, ai pësoi një numër lëndimesh në trup, përfshirë në kokë.<sup>162</sup> Pas

<sup>151</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR] dhe 211-212.

<sup>152</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 382 dhe 401.

<sup>153</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 404, 655, 1106.

<sup>154</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 655 dhe referencat aty.

<sup>155</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 655, 1017 dhe referencat aty; Deklarata mbi Pasojat, para. 45, 48-49.

<sup>156</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR]; Deklarata mbi Pasojat, para. [REDAKTUAR] dhe referencat aty; *shih gjithashtu*, [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu*, [REDAKTUAR].

<sup>157</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 666.

<sup>158</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 675; [REDAKTUAR] T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1527, rreshtat 13-16.

<sup>159</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

<sup>160</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 971; Deklarata mbi Pasojat, para. 42

<sup>161</sup> [REDAKTUAR] T. 31 maj 2023, publik, f. 1552, rreshti 22.

<sup>162</sup> Trupi Gjykses vë në dukje veçanërisht lëndimin që pësoi V01/04 si rezultat i [REDAKTUAR]; *shih* Aktgjykimin ( [Trial Judgment](#) ), para. [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR] që i referohet [REDAKTUAR].

lirimit, V01/04 tha [REDAKTUAR].<sup>163</sup> Ai fillimisht nuk [REDAKTUAR] sepse [REDAKTUAR] nuk ishte në gjendje [REDAKTUAR].<sup>164</sup>

105. Së fundi, Trupi Gjykses vë në dukje dëshminë e V01/04-ës, se ai ende ka vraga të dukshme [REDAKTUAR] nga keqtrajtimi fizik që pësoi;<sup>165</sup> dhe se ka ende dhimbje [REDAKTUAR]; dhe ka dhimbje koke [REDAKTUAR].<sup>166</sup>

106. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se është vërtetuar se V01/04, [REDAKTUAR], pësoi dëm fizik si rezultat i krimeve të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala është shpallur fajtor. Trupi Gjykses pranon gjithashtu se dëmi që pësoi V01/04 ka pasoja afatgjata.

107. **Dëmi mendor.** Gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, V01/04 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë.<sup>167</sup> Ai nuk dinte sa do të zgjaste ndalimi, as nuk pati kontakt me familjen e tij, ose me botën e jashtme.<sup>168</sup>

108. Gjatë ndalimit, V01/04 dëgjoi keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR] dhe i pa lëndimet që kishin pësuar si dhe gjendjen në të cilën ishin kur u sollën në dhomën ku mbaheshin.<sup>169</sup> Në një rast, [REDAKTUAR];<sup>170</sup> [REDAKTUAR].<sup>171</sup> V01/04 ishte gjithashtu i pranishëm kur, pas keqtrajtimit të rëndë, [REDAKTUAR].<sup>172</sup>

109. Si rezultat i ndalimit dhe keqtrajtimit të tij [REDAKTUAR] në FMK, V01/04 pësoi dëm mendor të atypëratyshëm dhe afatgjatë.

110. Si pasojë të drejtpërdrejtë, Trupi Gjykses vë në dukje se V01/04 përjetoi frikë nga keqtrajtimi i rëndë [REDAKTUAR], nga atmosfera e terrorit dhe frikësimit në FMK,

---

<sup>163</sup> [REDAKTUAR].

<sup>164</sup> [REDAKTUAR].

<sup>165</sup> *Shih gjithashtu*, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

<sup>166</sup> [REDAKTUAR].

<sup>167</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 403, 406.

<sup>168</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 404, 1100.

<sup>169</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 647; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

<sup>170</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 667.

<sup>171</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 667.

<sup>172</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 779-785.

si dhe nga kërcënimi me vdekje gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>173</sup> V01/04 pa gjithashtu [REDAKTUAR].<sup>174</sup> Kjo i shkaktoi dhimbje, pafuqi dhe zemërim të thellë.<sup>175</sup>

111. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se V01/04 u etiketua nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së që po e keqtrajtonin, se bashkëpunonte me autoritetet serbe dhe si “spiun”.<sup>176</sup> V01/04 përshkroi se u lëndua thellë shpirtërisht, përjetoi huti dhe tradhti të thellë nga ky stigmatizim, sepse nuk mund të kuptonte pse [REDAKTUAR]:

[REDAKTUAR].<sup>177</sup>

112. V01/04 shpjegoi më tutje se në çfarë forme tinëzare ndikoi fakti i të quajturit “spiun” në mirëqenien e tij shumë kohë pas ndalimit në FMK:

[REDAKTUAR].<sup>178</sup>

113. Trupi Gjykses thekson se ky është një aspekt i veçantë i dëmit mendor shkaktuar V01/04-ës, sepse akuzat e të qenit “bashkëpunëtor” ose “spiun” i shkaktojnë V01/04-ës dhe familjes së tij stigmë shoqërore afatgjate.

114. Në aspektin afatgjatë, V01/04 përjetoi traumë të mëtejshme [REDAKTUAR].<sup>179</sup> [REDAKTUAR].<sup>180</sup>

115. Trupi Gjykses thekson diagnozën e qartë [REDAKTUAR] si pasojë afatgjatë e keqtrajtimit të V01/04-ës gjatë ndalimit [REDAKTUAR].<sup>181</sup> [REDAKTUAR].<sup>182</sup> Konkretisht, V01/04 ende ka frikë për sigurinë e tij dhe vëzhgon vazhdimisht.

---

<sup>173</sup> [REDAKTUAR].

<sup>174</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR].

<sup>175</sup> [REDAKTUAR]; Deklarata mbi Pasojat, para. 62, 191.

<sup>176</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 403-404, 656, 688, 740, 947 dhe referencat aty; Deklarata mbi Pasojat, para. 68.

<sup>177</sup> [REDAKTUAR].

<sup>178</sup> [REDAKTUAR].

<sup>179</sup> [REDAKTUAR]; Deklarata mbi Pasojat, para. 67.

<sup>180</sup> [REDAKTUAR]; Deklarata mbi Pasojat, para. 69.

<sup>181</sup> [REDAKTUAR].

<sup>182</sup> [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR] V01/04 ka frikë [REDAKTUAR].<sup>183</sup> Si pasojë e kësaj frike, V01/04 nuk punon aktualisht [REDAKTUAR].<sup>184</sup> [REDAKTUAR] ndikojnë gjithashtu në jetën shoqërore dhe familjare të tij.<sup>185</sup> Sipas [REDAKTUAR], të gjitha simptomat e lartpërmendura burojnë drejtpërdrejt nga dhuna e ushtruar kundër V01/04-ës gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>186</sup>

116. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se, bazuar në tërësinë e gjasave, është vërtetuar se V01/04, [REDAKTUAR], pësoi dëm mendor të atypëratyshëm dhe afatgjatë si rezultat i krimeve të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme për të cilat z. Shala është shpallur fajtor.

117. **Dëmi material.** Mbrojtësi i Viktimave argumenton se [REDAKTUAR] V01/04-ës i kanë bërë të pamundur të jetojë jetën ashtu si do ta kishte jetuar më parë dhe veçanërisht se ai nuk është më në gjendje të mbajë veten [REDAKTUAR].<sup>187</sup> Ai parashtron se dëmi mendor shkaktuar V01/04-ës është e vetmja arsye që ai nuk mund të punojë.<sup>188</sup>

118. Trupi Gjykes gjykon se trauma e rëndë psikologjike, ankthi dhe dhimbjet, si ato që vuajti V01/04, jo vetëm që mund të rezultojnë në sëmundje fizike dhe mendore, por edhe mund të kenë pasoja në aftësinë e personit që të funksionojë në shoqëri. Për shembull, ato kanë pasoja në aftësinë e viktimës për të gjetur punë dhe për të fituar të ardhura të rregullta.

119. Në rastin konkret, Trupi Gjykes është i mendimit se, sikur të mos kishin ndodhur ndalimi arbitrar dhe tortura e V01/04-ës [REDAKTUAR] (me stigmën që lidhet me të etiketuarit “tradhtar”, “spiun”, ose “bashkëpunëtor i serbëve”)

---

<sup>183</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), [REDAKTUAR] dhe referencat aty; [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>184</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), [REDAKTUAR].

<sup>185</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), [REDAKTUAR].

<sup>186</sup> [REDAKTUAR].

<sup>187</sup> *Shih* Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims' Counsel Reparations Request](#)), para. 31-32; Deklarata mbi Pasojat, para. 92-96.

<sup>188</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims' Counsel Reparations Request](#)), para. 34.

[REDAKTUAR], dhe duke pasur parasysh moshën e V01/04-ës në kohën e ngjarjeve përkatëse, ka shumë të ngjarë që V01/04 do të kishte mundur të bënte “karrierë normale” dhe të gjente punë me të ardhura të rregullta.<sup>189</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor kontribuuan në mundësitë e humbura të V01/04-ës dhe pamundësinë për të rifituar pavarësinë financiare [REDAKTUAR].<sup>190</sup>

120. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se V01/04 pësoi humbje në të ardhura dhe iu dëmtuan planet për jetën.

121. **Përfundim.** Sipas mendimit të Trupit Gjykses, V01/04 ka vërtetuar, sipas standardit të kërkuar, dëmet e përshkruara më lart si edhe lidhjen shkakësore midis këtyre dëmeve dhe krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

122. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V01/04 përjetoi dëme fizike dhe mendore, si dhe dëm material, me pasoja afatgjata, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

### **3. Dëmi i pësuar nga V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 si viktimat të tërthorta**

123. Fillimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 kanë paraqitur material që vërteton lidhjen familjare me W04733-shin.<sup>191</sup> V03/04 ishte bashkëshortja e W04733-shit për [REDAKTUAR] dhe tani është e veja e tij. [REDAKTUAR]. Të gjithë janë anëtarë të ngushtë të familjes dhe rrjedhimisht supozohet se janë në lidhje të ngushtë me W04733-shin (viktimat të tërthorta).<sup>192</sup>

<sup>189</sup> *Shih* para. 62 më lart sa i përket shkakësisë faktike.

<sup>190</sup> *Shih* para. 63 më lart sa i përket shkakësisë faktike.

<sup>191</sup> *Shih* Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)), para. 26; Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), para. 29. Trupi Gjykses vë në dukje se Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi në bazë të një standardi më pak rigoroz (*Shih* rregullën 113(4) të Rregullores, Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), para. 12).

<sup>192</sup> *Shih* para. 53, 65 më lart.

124. Para se të vijojë me vlerësimin e dëmit që mund të kenë pësuar viktimat e tërthorta, Trupi Gjykses së pari do të japë konstatimet e tij për W04733-shin, për shkak të cilit anëtarët e familjes pretendojnë se pësuan dëm.

a) Dëmi i pësuar nga W04733

125. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se ai ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se W04733 u mbajt i ndaluar në mënyrë arbitrare dhe u keqtrajtua në FMK nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala.<sup>193</sup> Në lidhje me dëmin që pësoi W04733, Trupi Gjykses mbështetet kryesisht në dëshmitë me shkrim të W04733-shit dhe W01448-ës,<sup>194</sup> dëshmitë gojore të [REDAKTUAR],<sup>195</sup> [REDAKTUAR],<sup>196</sup> [REDAKTUAR],<sup>197</sup> [REDAKTUAR],<sup>198</sup> [REDAKTUAR]<sup>199</sup> dhe [REDAKTUAR]<sup>200</sup> si dhe prova mjekësore përkatëse.<sup>201</sup> Trupi Gjykses rikujton se ai ka konstatuar se W04733, W01448, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ishin të besueshëm dhe se mund të mbështetesh në dëshmitë e tyre.<sup>202</sup>

126. **Dëmi fizik.** Gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, W04733 u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala.<sup>203</sup> Konkretisht, W04733 u rrah brutalisht dhe vazhdimisht nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, të cilët e goditën me shqelma,

<sup>193</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 441-473, 640-653 dhe 689-706.

<sup>194</sup> KSC-BC-2020-04, F00562, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave në bazë të Rregullës 155 të Rregullores*, 4 korrik 2023, konfidencial, para. 70(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 gusht 2023, [F00562/RED](#).

<sup>195</sup> [REDAKTUAR].

<sup>196</sup> [REDAKTUAR].

<sup>197</sup> [REDAKTUAR].

<sup>198</sup> [REDAKTUAR].

<sup>199</sup> [REDAKTUAR].

<sup>200</sup> [REDAKTUAR].

<sup>201</sup> [REDAKTUAR].

<sup>202</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 98-119, 144-154, 169-175, 176-188, 198-199.

<sup>203</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 689-706.

grushte dhe me shkop gome dhe shkop bejsbolli.<sup>204</sup> Në një rast, W04733-shin e goditën në kokë, çka i shkaktoi gjakderdhje dhe si rezultat iu desh të lidhte kokën me fashë.<sup>205</sup> Përkundër lëndimit të dukshëm, njëri nga anëtarët e UÇK-së, ia preu fashën me thikë disa herë.<sup>206</sup> Sikurse [REDAKTUAR], W04733 u rrah deri humbi ndjenjat dhe i hodhën krip në plagë dhe sy.<sup>207</sup> Së fundi, W04733, sikurse të ndaluarit e tjerë, u mbajt në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi.<sup>208</sup>

127. Si pasojë e keqtrajtimit, W04733 pësoi lëndime dhe vraga të shumta, përfshirë një vragë në ballë, djegie me cigare në kraharor dhe shpatull, bërryl të lënduar, dhe dhëmbë të thyer.<sup>209</sup> Ai pësoi gjithashtu prerje në kyçin e dorës, nga një anëtarë i UÇK-së i cili e sulmoi me një thikë të madhe, që i shkaktoi gjakderdhje të madhe.<sup>210</sup>

128. Anëtarët e familjes të cilët pritën W04733-shin pas kthimit gjithashtu pohojnë gjendjen e tmerrshme fizike të tij: W04733 ishte i zbehur,<sup>211</sup> i përgjakur,<sup>212</sup> kishte plagë në të gjithë trupin,<sup>213</sup> dhe kishte humbur shumë peshë.<sup>214</sup>

129. Nga aspekti afatgjatë, W04733 tha se kishte vështirësi kur drejtonte dorën e majtë; [REDAKTUAR];<sup>215</sup> dhe që nga ngjarjet në FMK [REDAKTUAR], nga i cili kishte

<sup>204</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 690-691.

<sup>205</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 691, 1017.

<sup>206</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 691.

<sup>207</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 691, 694 dhe referencat aty.

<sup>208</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 593-638.

<sup>209</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 690-691, 700, 1097.

<sup>210</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 693. *Shih gjithashtu* SITF00019793-SITF00019810, f. SITF00019795, SITF00019801; **dr. Gasior**: T. 27 qershor 2023, publik, f. 2131, rreshti 8 deri f. 2132, rreshti 5.

<sup>211</sup> [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-14.

<sup>212</sup> [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 683, rreshtat 2-6; [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-21.

<sup>213</sup> [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 6-11; [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 824, rreshtat 18-19; [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshtat 6-17; [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 989, 4-9.

<sup>214</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 703; [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 6-9; [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-13; [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshtat 6-7; [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 988, rreshtat 21-25.

<sup>215</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2, f. 21-22.

vuajtur më parë, iu përkeqësua.<sup>216</sup> Krahas kësaj, W04733 tha se kishte probleme me shputa si pasojë e një rasti në FMK kur z. Shala e rrahu në shputat e këmbëve.<sup>217</sup>

130. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W04733 pësoi dëm fizik si rezultat i krimeve të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala është shpallur fajtor. Trupi Gjykses gjithashtu pranon se dëmi fizik që pësoi W04733 pati pasoja afatgjata.

131. **Dëmi mendor.** W04733 pati pasoja psikologjike të atypëratyshme dhe afatgjata si rezultat i mbajtjes në ndalim në FMK.

132. Së pari, sikurse të ndaluarit e tjerë në FMK, ai nuk u informua për arsyet e arrestimit dhe heqjes së lirisë.<sup>218</sup> Sikurse të ndaluarit e tjerë, edhe ai përjetoi atmosferë frike dhe brutaliteti në FMK dhe kishte frikë për jetën e tij.<sup>219</sup>

133. Së dyti, teksa po rrihej, W04733 u mor në pyetje dhe u akuzua vazhdimisht se bashkëpunonte me autoritete serbe dhe se kishte kryer krime të papërshtkrueshme.<sup>220</sup> Kjo i shkaktoi ndjenjë frustrimi dhe padrejtësie ndaj tij.<sup>221</sup> Ai u detyrua gjithashtu të bëhej dëshmitar i vuajtjeve dhe poshtërimit të personave të tjerë të ndaluar bashkë me të, përfshirë nga z. Shala, kur njëkohësisht po rrihej dhe poshtërohej në praninë e tyre.<sup>222</sup>

134. Në aspektin afatgjatë, W04733 tha se kishte fanitje, makthe dhe ishte nën stres si pasojë e ndalimit arbitrar dhe keqtrajtimit.<sup>223</sup> Ai irritohej.<sup>224</sup> Gjithashtu kishte frikë dhe ruhej gjatë gjithë kohës, me frikën se mos ai dhe familja e tij po ndiqeshin.<sup>225</sup>

<sup>216</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. 40.

<sup>217</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 448; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3, f. 44, rreshtat 3-7.

<sup>218</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 441, 470-473.

<sup>219</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 645-653; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2, f. 24; Deklarata mbi Pasojat, para. 127.

<sup>220</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 692, 694.

<sup>221</sup> Deklarata mbi Pasojat, para. 123.

<sup>222</sup> Deklarata mbi Pasojat, para. 125.

<sup>223</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 701.

<sup>224</sup> Deklarata mbi Pasojat, para. 141-144.

<sup>225</sup> Deklarata mbi Pasojat, para. 139 dhe referencat aty.



Konkretisht, ai nuk kërkoi ndihmë mjekësore për lëndimet që kishte pësuar në FMK nga frika se po e ndiqnin.<sup>226</sup> W04733 tha vetë se ndihej “i dërmu” si rezultat i asaj që përjetoi në FMK.<sup>227</sup>

135. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se W04733 pësoi dëm mendor si rezultat i krimeve të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala është shpallur fajtor. Trupi Gjykes pranon gjithashtu se dëmi mendor që pësoi W04733 pati pasoja afatgjata.

- a) Dëmi i pësuar nga V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04

136. **Dëmi mendor.** Në momentin e arrestimit të W04733-shit, familja përshkroi se përjetuan frikë dhe ankth nga mosdija se ku e çuan babain dhe bashkëshortin e tyre dhe nëse do ta shihnin përsëri.<sup>228</sup>

137. Pas lirimit të W04733-shit, anëtarët e familjes ishin të shqetësuar kur panë gjendjen në të cilën ishte, si fizike ashtu dhe mendore. [REDAKTUAR] dha dëshmi në sallë të gjyqit: “Babai im kur e kanë sjellë ka qenë në kushte tërësisht jonjerëzore. Kundërmonte erë të keqe. Domethënë, mos – papastërti”.<sup>229</sup> V03/04, gruaja e W04733-shit, dëshmoi gjithashtu në lidhje me herën e parë që pa burrin e vet pas lirimit të tij. Jo kujtoi qartë: “E kemi pranë, e kemi marrë. I palarë, i përgjakun, era e rrobave. [...]aty kemi pas një gjendje shumë të vështirë, psiqike, morale, të gjitha. Kanë qajt djali dhe vajza e vogël. [...] e kemi pastru”.<sup>230</sup>

138. Familja gjithashtu pati vuajtje mendore nga pasoja afatgjatë e ndalimit dhe keqtrajtimit mbi gjendjen psikologjike të W04733-shit.<sup>231</sup> [REDAKTUAR] përshkroi

<sup>226</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 701; Deklarata mbi Pasojat, para. 132.

<sup>227</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9), f. 18, rreshtat 5-6.

<sup>228</sup> [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, konfidencial, f. 687, rreshtat 18-24; [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 993, rreshtat 19-21.

<sup>229</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 624; [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 7-8.

<sup>230</sup> [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, publik, f. 809, rreshtat 4-13.

<sup>231</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 704.

prekshëm ndikimin që pati ndalimi dhe keqtrajtimi në FMK ndaj babait të tij (W04733): “Baba ka pasë trauma psikologjike, i shkatërrum nga plagat që i ka marrë në kampin e mbajtjes në Kukës [...] Ndryshoi pak – të gjitha – në agresivitet, fjetje jo të mirë, në anën psikologjike mendore”.<sup>232</sup> Familjes së W04733-shit iu desh të mësohej të jetonte me ndryshimet në personalitet dhe sjelljen që e shfaqte, si dhe simptomat e traumës.<sup>233</sup> Dëshmitë e anëtarëve të familjes së W04733-shit janë domethënëse në këtë aspekt. Për shembull, [REDAKTUAR] dëshmoi se: “Përvoja ka qenë e hidhur pse jemi përball gjithë familja [...] ndijshim shpirtnisht për ato çka kishin bërë”.<sup>234</sup> V03/04 dha dëshmi se krimet e kryera ndaj W04733-shit në FMK patën ndikim të rëndë për tërë familjen: “Ka ndikue shumë rëndë [...] n’gjendjen shëndetësore të burrit por edhe të gjithë familja kemi pas strese, kemi fitu ndonjë sëmundje, ndonjë trauma, vetëm jemi përcjellë kështu me terapi, me medikamente.”<sup>235</sup> Kur u pyet çfarë ndikimi patën për jetën e saj si gruaja e tij ato që përjetoi burri i saj, V03/04 dëshmoi: “Ka ndikue, shumë momente të vështira. Shumë momente të vështira si nuk mundte t’i numëroj të gjitha ato. Secila në veta ka pasë ndikimin sa më fortë, sa më të vështirë, për mua dhe gjithë familjen, që na ka ndiku edhe neve në emocione, në psikik”.<sup>236</sup>

139. Së fundi, akuzat ndaj W04733-shit nga anëtarë të UÇK-së i kontribuuan stigmës që iu hodh edhe familjes. Si pasojë, disa nga fëmijët e W04733-shit patën frikë dhe pasiguri dhe si rezultat nuk patën mundësi të realizonin planet për jetën.<sup>237</sup>

<sup>232</sup> [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 686, rreshtat 15-16; f. 687, rreshtat 4-5. *Shih gjithashtu*, [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 989, rreshtat 12-13: “Karakteri i tij s’kishte ndryshu. Ishte ashtu siç ishte, po ishte i thym kështu të tambesh. Fizikisht ish shumë i rrëzum, them ne, i ram;”; [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 913, rreshtat 24-25: “Psikikisht, ka ndryshu krejt, jo sikur përpara.”

<sup>233</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 41.

<sup>234</sup> [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 687, rreshtat 9-15.

<sup>235</sup> [REDAKTUAR] T. 28 mars 2023, publik, f. 826, rreshtat 7-9.

<sup>236</sup> [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 846, rreshtat 5-8.

<sup>237</sup> [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, f. 847, publik, rreshtat 10-19; f. 847, rreshti 24 deri f. 848, rreshti 6; f. 877, rreshtat 18-20; [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, f. 912, publik, rreshtat 8-21; [REDAKTUAR] T. 27 mars 2023, publik, f. 687, rreshti 25 deri f. 688, rreshti 5.

140. **Dëmi material.** Trupi Gjykues rikujton së pari se, si rezultat i dëmit fizik dhe mendor për shkak të ndalimit dhe keqtrajtimit në FMK, pas kthimit W04733 nuk ishte më në gjendje të mbante familjen.<sup>238</sup>

141. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues është i mendimit se, sikur të mos kishin ndodhur ndalimi arbitrar dhe tortura, së bashku me stigmën që lidhet me të etiketuarit “tradhtar”, “spiun”, ose “bashkëpunëtor i serbëve”, dhe duke pasur parasysh moshën e tij në kohën e ngjarjeve ([REDAKTUAR]),<sup>239</sup> ka shumë të ngjarë që W04733 do të kishte mundur të bënte “karrierë normale” dhe të gjente punë me të ardhura të rregullta. Trupi Gjykues gjithashtu është bindur se krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor kontribuuan në humbjen e mundësive dhe aftësisë së W04733-shit për të rifituar pavarësinë financiare dhe për të mbajtur familjen. Si rezultat, familja humbi mbajtësin kryesor të familjes.<sup>240</sup>

142. Krahas kësaj, Trupi Gjykues vë në dukje parashtrimin e Mbrojtësit të Viktimave se viktimat e tërthorta patën disa shpenzime lidhur me kujdesin mjekësor të W04733-shit për të trajtuar lëndimet fizike që pësoi në FMK, si dhe shëndetin që po i përkeqësohej nga viti në vit.<sup>241</sup> Si aspekt i përgjithshëm, Trupi Gjykues gjykon se shpenzimet financiare lidhur me trajtimin mjekësor të dëmit fizik ose psikologjik që ka pësuar një viktimë e drejtpërdrejtë si rezultat i krimeve përbëjnë një element të dëmit material shkaktuar viktimave të tërthorta. Trupi Gjykues do të diskutojë në

---

<sup>238</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1093; Deklarata mbi Pasojat, para. 178-179. V03/04 dha dëshmi në lidhje me këtë: “Gjithashtu kemi pasë humbje në ekonomi për gjendjen shëndetësore të bashkëshortit, për arsye se punonte edhe jashtë detyre kur u kthente te shtëpia. Mund të punonte diçka bahçen, me mbjellë misër, me u angazhu pak edhe nga bujqësia. Por pas këtyre torturave s’ka mujt as një vit me punu më dhe me përfitue diçka për familje, për jetesën, për shpenzimet familjare. Për të gjitha këto na ka dëmtue”, [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 875, rreshti 24 deri f. 876, rreshti 5.

<sup>239</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 49.

<sup>240</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 51.

<sup>241</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 48-52.

pjesët e mëposhtme shumën e saktë të shpenzimeve që pretendohet se shpenzoi familja e W04733-shit dhe aspektin e dokumentacionit mbështetës.<sup>242</sup>

143. Së fundi, Trupi Gjykses vë në dukje se si rezultat i krimeve të kryera kundër W04733-shit në FMK, familja kishte frikë për sigurinë dhe si pasojë zgjodhën dhe morën vendime të cilat u kufizuan perspektivat për të ardhmen. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje veçanërisht: (i) ndërprerjen e shkollimit të [REDAKTUAR] vajzave të W04733-shit ([REDAKTUAR])<sup>243</sup> dhe [REDAKTUAR]<sup>244</sup> për shkak të stigmës që lidhej me W04733-shin lidhur me akuzat që u bënë kundër tij në FMK; dhe (ii) [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nuk ndoqën karrierën e zgjedhur për të njëjtën arsye.<sup>245</sup> [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhanë dëshmi më tutje se familja nuk ndihej e sigurt, sepse kishin frikë se diçka dhe më e keqe do t'u ndodhte. Gruaja e W04733-shit në atë kohë, V03/04, shpjegoi gjithashtu se [REDAKTUAR] vajzat ndërprejnë shkollimin, sepse familja brengosej për sigurinë e tyre.<sup>246</sup> Në lidhje me këtë, [REDAKTUAR] deklaroi: "Po edhe te ne [REDAKTUAR], tjetër perspektivë".<sup>247</sup> "Por disa gjind janë konë që -- si familje, si i thojnë, spiun. Prej kësaj që çka ka ndodhë te baba". Dëshmia e V03/04- tregon se

<sup>242</sup> *Shih* para. 179 më poshtë.

<sup>243</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1093; Deklarata mbi Pasojat, para. 160-163. V03/04 dha dëshmi në lidhje me këtë: "Atë kohë kanë ndërpre vajzat shkollimin për shkaqe sigurie. Se ndodhshin lloj-lloj raste të këqija, amorale. Dhe për këtë arsye na i kemi ndalu, ua kam ndërpre shkollimin vajzave", [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 847, rreshtat 15-19; në lidhje me dëmin material për shkak të ndërprerjes dhe humbjes së shkollimit, *shih* [Ongwen Reparations Order](#), para. 374.

<sup>244</sup> V02/04 dha dëshmi se: "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, konfidencial, f. 1018, rreshtat 13-14.

<sup>245</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 1093; Deklarata mbi Pasojat, para. 172.

<sup>246</sup> V03/04 dha dëshmi lidhur me pasojat për vajzat e saj në karrierën e tyre dhe përgjithësisht për planet për jetën për shkak të ndërprerjes së shkollimit: "Ishte e vështirë. Ishte e vështirë. Po patjetër që të mos të ndodhë diçka edhe më e keqe u duhte të pajtohemi me i ndaluar në shtëpi, me e marr me disa punë tjera, biznese punëdoreje, me punu pak te shtëpia dhe kështu", [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 877, rreshtat 18-20.

<sup>247</sup> [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 960, rreshti 17. [REDAKTUAR] dëshmoi më tej: "Vëllai i madh kështu ka qenë në polici dhe dikund në 2006 apo 2007, u largu se e ka ndi veten jo ashtu të sigurtë". Sipas tij, kjo lidhej me atë që i kishte ndodhur babait të tij, *shih* [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 960, rreshtat 21-25. [REDAKTUAR] dëshmoi gjithashtu: "Kam qenë edhe unë për në polici, më ka dalë emri që jam pranuar, pastaj e kanë tërhekur", [REDAKTUAR] T. 30 mars 2023, publik, f. 961, rreshtat 9-11.

dëmi që iu shkaktua familjes vazhdon deri në ditët e sotme: “Me strese, unë dhe gjithë fëmijët. Shumë kohë, shumë kohë, as sot nuk mund t’i shlyjmë ato brenga nga që çka kemi përjetue”.<sup>248</sup> Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se krimet e kryera ndaj W04733-shit ndryshuan planet për jetën të anëtarëve të familjes, meqë stigma që lidhej me atë që i ndodhi W04733-shit në FMK preku dhe familjen, e cila shihej si familje spiuni, dhe u shkaktoi humbje të mundësive që ndërlidhet me të. Rrjedhimisht, viktimat e tërthorta pësuan dëm material, dëm për planet për jetën si rezultat i krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor në lidhje me W04733-shin.<sup>249</sup>

144. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V02/04, V03/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 kanë vërtetuar lidhjen e tyre familjare me W04733-shin, i cili ishte viktimë e drejtpërdrejt e krimeve të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala u shpall fajtor. Trupi Gjykses konstaton më tej se V02/04, V03/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 pësuan dëm mendor dhe material, me pasoja afatgjata, si rezultat krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala u shpall fajtor në lidhje me W04733-shin.

## VI. URDHRI PËR ZHDËMTIM KUNDËR Z. SHALA

145. Ky urdhër lëshohet drejtpërdrejt kundër z. Shala në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.<sup>250</sup>

### A. PËRFITUESIT E ZHDËMTIMEVE DHE DËMI I PËSUAR

146. Në pjesën pararendëse, Trupi Gjykses përcaktoi shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore. Sikurse u konstatua më lart, V01/04 ka pësuar dëm fizik, mendor dhe material, ndërsa V02/04, V03/04, V04/04, V05/04,

---

<sup>248</sup> [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR] dhe referencat aty.

<sup>249</sup> *Shih, ngjashëm*, Urdhrin mbi Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 141.

<sup>250</sup> *Shih* para. 80 më lart.

V06/04, V07/04 dhe V08/04 kanë pësuar dëm mendor dhe material si pasojë e krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

## B. LLOJET DHE MODALITETET E ZHDËMTIMEVE

### 1. Parashtrimet

147. Mbrojtësi i Viktimave parashtron se viktimat në këtë çështje gjyqësore u paraqitën kryesisht për të kërkuar drejtësi dhe për të zbuluar të vërtetën për atë që ndodhi.<sup>251</sup> Për këtë arsye, Mbrojtësi i Viktimave kërkon që dëmi i pësuar prej tyre të njihet specifikisht si formë zhdëmtimi më vete dhe secili prej tyre të kompensohet në vlerë monetare.<sup>252</sup>

148. Mbrojtësi i Viktimave argumenton se në vlerësimin e kompensimit Trupi Gjykues duhet ketë qasje të njëjtë me atë që u përdor prej Trupit Gjykues në çështjen gjyqësore *Mustafa*.<sup>253</sup>

149. Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave propozon që në përcaktimin e shumave të kompensimit që do t'u akordohen viktimave të drejtpërdrejta, Trupi Gjykues të marrë parasysh faktorët në vijim: (i) dëmin fizik që pësoi viktimat nga arrestimi, ndalimi dhe keqtrajtimi; (ii) dëmin mendor të pësuar nga arrestimi, ndalimi dhe keqtrajtimi; (iii) kohëzgjatjen e dëmit fizik dhe mendor të lartpërmendur; (iv) dëmin material, përfshirë humbjen e punës dhe të të ardhurave, si edhe humbjen e të ardhurave të mundshme; (v) mundësitë e humbura, përfshirë në punësim, arsimim dhe ndihma sociale dhe, më përgjithësisht, në planet për jetën; (vi) peshën e krimeve; (vii) nëse viktimës i është akorduar tashmë ndonjë formë zhdëmtimi/kompensimi; dhe (viii)

---

<sup>251</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 2.

<sup>252</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 3; *shih gjithashtu*, Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të 30 Qershorit 2023 ([Victims' Counsel 30 June 2023 Submissions](#)), para. 35.

<sup>253</sup> [Victims' Counsel 30 June 2023 Submissions](#), (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të 30 Qershorit 2023), para. 36.

kompensimin e akorduar në çështje gjyqësore të ngjashme lidhur me torturën, trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës dhe ndalimin arbitrar në gjykata të tjera.<sup>254</sup>

150. Në lidhje me viktimat e tërthorta, Mbrojtësi i Viktimave propozon që në përcaktimin e shumave të kompensimit që do t'u akordohen këtyre viktimave, Trupi Gjyqësor të marrë parasysh faktorët në vijim: (i) llojin e marrëdhënies midis viktimës së drejtpërdrejtë dhe viktimave të tërthorta; (ii) dëmin e pësuar nga krimi dhe ndikimin e tij mbi viktimat e tërthorta; (iii) kohëzgjatjen e dëmit; (iv) dëmin material, përfshirë humbjen e punës dhe të të ardhurave, si edhe humbjen e të ardhurave të mundshme; (v) mundësitë e humbura nga viktimat e tërthorta, përfshirë në punësim, arsimim dhe ndihma sociale dhe, më në përgjithësi, planet për jetën; (vi) peshën e krimeve; (vii) nëse viktimave të tërthorta u është akorduar tashmë ndonjë formë zhdëmtimi/kompensimi; dhe (viii) kompensimin e akorduar në çështje gjyqësore të ngjashme për torturë, trajtim çnjerëzor ose poshtëruës dhe për ndalim arbitrar në gjykata të tjera.<sup>255</sup>

151. Mbrojtja përgjigjet se mbështetja në Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* është e pavend dhe nuk mund të trajtohet si precedent, përveç kur ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të ndjekur qasjen e përdorur në atë çështje gjyqësore në rrethanat specifike në këtë çështje gjyqësore. Mbrojtja parashtron se, ndryshe nga z. Shala, z. Mustafa ishte komandant dhe u akuzua për përgjegjësi penale si epror dhe se, as numri i viktimave të pretenduara, as gjendja financiare e dy të akuzuarve në këto dy çështje gjyqësore, nuk është e ngjashme.<sup>256</sup>

---

<sup>254</sup> [Victims' Counsel 30 June 2023 Submissions](#), (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të 30 Qershorit 2023), para. 53.

<sup>255</sup> [Victims' Counsel 30 June 2023 Submissions](#), (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të 30 Qershorit 2023), para. 54.

<sup>256</sup> KSC-BC-2020-04, F00585, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave me Gjashtë Shtojca Konfidenciale*, 12 korrik 2023, konfidenciale, para. 10 (Përgjigja e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të 30 Qershorit 2023). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 korrik 2023, [F00585/RED](#).

## 2. Vendimi i Trupit Gjykses

152. Në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, Trupi Gjykses do të specifikojë më poshtë zhdëmtimet e përshtatshme.

153. Para kësaj, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se shpallja fajtor dhe dënimi i dhënë në Aktgjykim përbën në vetvete një lloj mjeti juridik për viktimat që, në nenin 22(3) të Ligjit, përfshihet në kuadër të së drejtës së “pranimi”. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton se pranimi i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare është një formë e rëndësishme mjeti juridik për viktimat.<sup>257</sup> Në këtë çështje gjyqësore, vendimi i fajësisë dhe dënimi i dhënë në Aktgjykim shërben për pranimin dhe përshkrimin me hollësi të krimeve që pësuan viktimat, si dhe për vënien e z. Shala para përgjegjësisë për krimet e rënda të kryera dhe për dëmet që u shkaktoi atyre.

154. Procesi i gjyqimit në këtë çështje, që çoi në shpalljen fajtor dhe dënimin e z. Shala u ofroi gjithashtu mundësi viktimave – me gjithë atmosferën e frikës dhe të frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron të Kosovë – që të dëgjoheshin dhe të kërkonin drejtësi dhe zhdëmtim për krimet e kryera më shumë se dy dekada më parë kundër tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre që nuk janë më.

155. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e bëra në Aktgjykim lidhur me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHS-së, familjeve të tyre dhe, më gjerësisht, kundër atyre që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se u kryen nga anëtarë të atëhershëm të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, kundër shqiptarëve kosovarë.<sup>258</sup>

---

<sup>257</sup> *Shih* Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 1063; Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave ([Victims' Procedural Rights Decision](#)), para. 26.

<sup>258</sup> [Trial Judgment](#), (Aktgjykimi), para. 96-97 dhe referencat aty.



156. Së fundi, vendimi i fajësisë dhe dënimi në Aktgjykim kontribuojnë në realizimin e të drejtave të viktimave dhe, më gjerësisht, të të drejtave të anëtarëve të familjeve dhe komuniteteve të tyre, për të mësuar të vërtetën për atë që ndodhi.<sup>259</sup>

157. Sa u përket zhdëmtimeve të përshtatshme sipas nenit 22(8) të Ligjit, Trupi Gjykses rikujton llojet e dëmeve të pësuar nga viktimat<sup>260</sup> dhe kontekstin e çështjes gjyqësore, konkretisht: atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë; nevojën për të ruajtur anonimitetin e viktimave kundrejt publikut; dhe nevojën për të shmangur krijimin e tensioneve brenda komunitetit.

158. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave, Trupi Gjykses konstaton se kompensimet individuale dhe kolektive janë lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm i zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore, pasi do të ofrojnë njëfarë ndihme financiare për viktimat.

## C. SHKALLA E PËRGJEGJËSISË SË Z. SHALA PËR ZHDËMTIMET

### 1. Parashtrimet

#### a) Mbrojtësi i Viktimave

159. **Korniza ligjore.** Mbrojtësi i Viktimave propozon që Trupi Gjykses të marrë parasysh jurisprudencën dhe praktikën e GJEDNJ-së lidhur me akordimin e kompensimit të drejtë dhe Udhëzuesin e Punës të GJEDNJ-së lidhur me kërkesat për kompensim të drejtë që përmbajnë udhëzime relevante për vlerësimin e dëmit mendor dhe material.<sup>261</sup>

---

<sup>259</sup> Shih [UN Basic Principles on Reparations](#), para. 22(b), 24; mbi të drejtat e viktimave për të mësuar të vërtetën, shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave ([Victims' Procedural Rights Decision](#)), para. 26.

<sup>260</sup> Shih para. 100-144 më lart.

<sup>261</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 47; [Victims' Counsel 30 June 2023 Submissions](#), (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave të 30 Qershorit

160. Në lidhje me legjislacionin përkatës të Kosovës për vlerësimin e zhdëmtimeve, Mbrojtësi i Viktimave vë në dukje Udhëzuesin për Caktimin e Kritereve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jomaterial të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 27 shkurt 2023 (Udhëzuesi i Kosovës).<sup>262</sup> Megjithatë, Mbrojtësi i Viktimave thekson se Udhëzuesi i Kosovës është për proceset gjyqësore vendore për kompensim para gjykatave civile në Kosovë, ndërsa kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me dëmet e pësuar si rezultat i krimeve të luftës të shkaktuara nga anëtarë të UÇK-së kundër shqiptarëve kosovarë, me stigmatizimin dhe pasojat që shoqërojnë posaçërisht këto krime.<sup>263</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se Udhëzuesi i Kosovës duhet të konsiderohet nga Trupi Gjyqësor si pikë referimi, veçanërisht në lidhje me llogaritjen e shumave monetare për zhdëmtimet në kontekstin ekonomik të Kosovës, por se vendimi i Trupit Gjyqësor nuk kufizohet prej tij.<sup>264</sup>

161. **Aktekspertizat.** Mbrojtësi i Viktimave argumenton se synimi i vlerësimeve në Aktekspertizën *Lerc*, në lidhje me dëmin material që pësuan V01/04 dhe V02/04 - V08/04 si rezultat i krimeve të kryera nga z. Shala, përkatësisht kundër V01/04-ës dhe W04733-shit, është që të tregojnë masën e dëmit material individual të pësuar nga viktimat, sikurse do të ishte vepruar në procese të zakonshme për dëme/kompensim. Këto vlerësime janë për t'i shërbyer Trupit Gjyqësor si pikë referimi në vlerësimin e dëmit të pësuar nga viktimat dhe në përcaktimin e zhdëmtimeve të mjaftueshme/të përshtatshme.<sup>265</sup> Mbrojtësi i Viktimave pranon se, sidomos sa i përket V01/04-ës,

---

2023), para. 37-48, ku i referohet [Practice direction issued by the President of the Court in accordance with Rule 32 of the Rules of Court](#)) të GJEDNJ-së.

<sup>262</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 14. *Shih:* Gjykata Supreme e Kosovës, S.C.F. nr.: 41/2023, *Udhëzime për Caktimin e Kritereve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jomaterial*, 27 shkurt 2023.

<sup>263</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 16.

<sup>264</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 14-17.

<sup>265</sup> [Victims' Counsel Expert Answers](#), (Përgjigjet e Ekspertit të Mbrojtësit të Viktimave), para. 9.

shifrat në Aktekspertizën *Lerc* janë konsiderueshëm më të larta se çdo urdhër zhdëmtimi që mund të jepet.<sup>266</sup>

162. Më tej, Mbrojtësi i Viktimave kundërshton konstatimet në Aktekspertizën e Mbrojtjes, e cila, sipas tij, ka vlerë provuese të ulët si rezultat i gabimeve që përmban dhe i mungesës së qartësisë.<sup>267</sup>

163. **V01/04.** Për dëmin fizik të V01/04-ës, Mbrojtësi i Viktimave kërkon zhdëmtim simbolik në vlerë monetare 10.000 euro. Mbrojtësi i Viktimave parashtron se kjo shumë është e arsyeshme dhe e përshtatshme, nëse merren parasysh Udhëzuesi i Kosovës, shumat e akorduara për dëmin fizik në çështjen gjyqësore *Mustafa*, si edhe kompensimin e drejtë për keqtrajtim fizik të akorduar nga GJEDNJ-ja në çështje gjyqësore të ngjashme.<sup>268</sup>

164. Për dëmin mendor të V01/04-ës, Mbrojtësi i Viktimave kërkon zhdëmtim në vlerë monetare 30.000 euro. Mbrojtësi i Viktimave argumenton se, ndonëse zhdëmtimi në vlerë monetare në çështjen gjyqësore *Mustafa* nuk ishte më shumë se 10.000 euro, në këtë çështje gjyqësore V01/04 pësoi dëm mendor [REDAKTUAR], dhe ky dëm ishte edhe i menjëhershëm, edhe afatgjatë.<sup>269</sup> Mbrojtësi i Viktimave parashtron se kjo shumë është e arsyeshme dhe e përshtatshme nëse merren parasysh Udhëzuesi i Kosovës dhe shumat e akorduara për kompensim të drejtë nga GJEDNJ-ja në çështje gjyqësore të ngjashme.<sup>270</sup>

165. Për dëmin material të V01/04-ës, Mbrojtësi i Viktimave kërkon zhdëmtim simbolik me vlerë monetare 60.000 euro, duke theksuar se në këtë çështje gjyqësore – ndryshe nga procesi *Mustafa* – dëmi mendor që pësoi V01/04 është shkaku i vetëm i

---

<sup>266</sup> [Victims' Counsel Expert Answers](#), (Përgjigjet e Ekspertit të Mbrojtësit të Viktimave), para. 10.

<sup>267</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 32; shih gjithashtu *Pyetjet e Mbrojtësit të Viktimave për Eksperten e Mbrojtjes* ([Victims' Counsel Questions for Defence Expert](#)), para. 5.

<sup>268</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 22.

<sup>269</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 29.

<sup>270</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 30.

pamundësisë së tij për të punuar.<sup>271</sup> Mbrojtësi i Viktimave vë në dukje dy skenarët e përshkruar në Aktekspertizën *Lerc* në lidhje me dëmin material për humbjen në të ardhura që pësoi V01/04 si rezultat i krimeve (përkatësisht, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]).<sup>272</sup> Ai gjithashtu thekson se Aktekspertiza e Mbrojtjes e vlerësoi dëmin material të V01/04-ës në shumën [REDAKTUAR].<sup>273</sup>

166. Duke parë këto vlerësime, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se shifra e kërkuar është konsiderueshëm më e ulët, pasi merr parasysh kontekstin ekonomik në Kosovë dhe jurisprudencën e DHS-së.<sup>274</sup>

167. **V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 (viktimat e tërthorta).** Mbrojtësi i Viktimave kërkon kompensim monetar prej 10.000 eurosh për dëmin mendor që pësoi V03/04 si gruaja (tani e veja) e W04733-shit. Mbrojtësi i Viktimave sugjeron se duhet bërë dallim midis dëmit që pësoi V03/04 dhe dëmit që pësuan viktimat e tërthorta. Arsyeja për këtë është se V03/04 ishte për [REDAKTUAR] e martuar me W04733-shin përpara ndalimit dhe keqtrajtimit të tij; ajo e ndërtoi jetën me të dhe rritën bashkë [REDAKTUAR] fëmijë, dhe ajo vazhdoi të jetonte me W04733-shin edhe dy dekada pas krimeve të kryera në FMK, deri kur ai ndërroi jetë.<sup>275</sup>

168. Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave kërkon që V02/04-ës, V04/04-ës, V05/04-ës, V06/04-ës, V07/04-ës dhe V08/04-ës ([REDAKTUAR]), t'u akordohen 8.000 euro për person për dëmin mendor që pësuan. Mbrojtësi i Viktimave mendon se do të ishte e papërshtatshme të bëhej dallim [REDAKTUAR], sepse të gjithë vuajtën në mënyrë të barabartë. Mbrojtësi i Viktimave argumenton gjithashtu se këto shuma janë të përligjura, duke marrë parasysh Udhëzuesin e Kosovës, praktikën në DHS,

---

<sup>271</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 34.

<sup>272</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 32.

<sup>273</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 32.

<sup>274</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 32.

<sup>275</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 45, 58 (A)(ii).

jurisprudencën relevante të GJEDNJ-së, peshën dhe kontekstin e krimeve të kryera kundër W04733-shit nga anëtarë të UÇK-së dhe dëmin që pësoi familja e tij.<sup>276</sup>

169. Sa i përket dëmit material, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se shuma prej gjithsej 50.000 eurosh është e përshtatshme për zhdëmtimin e dëmit material që pësuan viktimat e tërthorta.<sup>277</sup> Mbrojtësi i Viktimave arrin në këtë shifër pasi shqyrtoi shifrat në provat e paraqitura nga W04733<sup>278</sup> dhe V03/04<sup>279</sup> për shpenzimet mjekësore të paguara nga familja,<sup>280</sup> si edhe vlerësimin në Aktekspertizën *Lerc* për humbjen në të ardhura të familjes si rezultat i pamundësisë së W04733-shit për të punuar pas krimeve ([REDAKTUAR]).<sup>281</sup> Mbrojtësi i Viktimave e konsideron këtë vlerësim krejt të arsyeshëm, nisur nga premisa modeste mbi të cilën u bazua, konkretisht se dikush me përvojën dhe aftësitë e W04733-shit nuk do të kishte fituar më shumë se paga mesatare vjetore në Kosovë.<sup>282</sup>

170. Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se për dëmin material të shkaktuar nga humbja në të ardhura dhe shpenzimet për trajtim mjekësor, zhdëmtimi duhet t'i akordohet kolektivisht të gjithë familjes dhe t'u ndahet anëtarëve të saj në përputhje me udhëzimet e tyre. Kjo sepse të gjithë anëtarët e familjes kanë marrë pjesë në mënyra të ndryshme në përballimin e këtyre shpenzimeve dhe kanë kontribuar në mirëqenien ekonomike të familjes.<sup>283</sup>

#### b) Mbrojtja

---

<sup>276</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 46-47.

<sup>277</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 54.

<sup>278</sup> W04733 tha se [REDAKTUAR], *shih* [REDAKTUAR].

<sup>279</sup> V03/04 dëshmoi se shpenzimet e paguara nga familja për trajtimin mjekësor të W04733-shit arrinin deri në 150.000 euro, *shih* [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 876, rreshti 18.

<sup>280</sup> Mbrojtësi i Viktimave i llogariti këto shpenzime në afërsisht 30.000 euro; *shih* Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim ([Victims' Counsel Reparations Request](#)), para. 54.

<sup>281</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 51, 54.

<sup>282</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 50.

<sup>283</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 55.

171. **Korniza ligjore.** Mbrojtja kërkon gjithashtu që Trupi Gjykues të kërkojë zbatimin e standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja në Udhëzuesin e Punës mbi kërkesat për kompensim të drejtë dhe në jurisprudencën relevante, të cilave u referohet dhe në të cilat mbështetet Mbrojtësi i Viktimave.<sup>284</sup> Në lidhje me këtë aspekt, Mbrojtja thekson në veçanti kushtin e përcaktuar në Udhëzuesin e Punës së GJEDNJ-së lidhur me paraqitjen e “provave relevante për të vërtetuar, aq sa është e mundur, jo vetëm ekzistencën, por edhe shumën ose vlerën e dëmit”.<sup>285</sup> Megjithatë, Mbrojtja argumenton se jurisprudenca e GJEDNJ-së e cituar nga Mbrojtësi i Viktimave në lidhje me kompensimin e drejtë nuk ka të bëjë me rrethana qartësisht të krahasueshme me ato në këtë çështje gjyqësore.<sup>286</sup>

172. **Shkalla e përgjegjësisë së z. Shala.** Mbrojtja parashtron se z. Shala nuk mund të mbahet përgjegjës për kompensimin e dëmit që nuk është shkaktuar drejtpërdrejt nga një krim për të cilin ai nuk u shpall fajtor dhe nuk mund të pritet që ai të kompensojë dëmin e shkaktuar nga krimet apo veprimet e kryera nga anëtarë të tjerë të UÇK-së gjatë periudhës kohore përkatëse.<sup>287</sup>

173. Mbrojtja gjithashtu parashtron se të gjitha kërkesat e paraqitura nga Mbrojtësi i Viktimave në lidhje me dëmin e pretenduar nga viktimat janë të tepruara dhe joproporcionale.<sup>288</sup>

174. **Aktekspertizat.** Mbrojtja kundërshton konstatimet në Aktekspertizën *Lerc* si të bazuara në të dhëna statistikore të përgjithshme dhe jo në të dhëna dhe informacione faktike që lidhen me rrethanat personale të viktimave të pretenduara. Sipas Mbrojtjes

---

<sup>284</sup> [Defence Response to 30 June 2023 Submissions](#), (Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të 30 Qershorit 2023), para. 12-13.

<sup>285</sup> [Defence Response to 30 June 2023 Submissions](#), (Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të 30 Qershorit 2023), para. 13, që i referohet [ECtHR Practice Direction](#), para. 9.

<sup>286</sup> [Defence Response to 30 June 2023 Submissions](#), (Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të 30 Qershorit 2023), para. 15 dhe referencat aty.

<sup>287</sup> Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 15.

<sup>288</sup> Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, para. 16.

kjo bën që Aktekspertiza të jetë tejet e gjerë dhe e përgjithshme dhe në përfundimet e saj për këtë çështje gjyqësore nuk mund të mbështetesh.<sup>289</sup>

175. Së fundi, Mbrojtja parashtron se Aktekspertiza e Mbrojtjes i përgjigjet drejtpërdrejt Aktekspertizës *Lerc* dhe paraqet një përlllogaritje alternative të shumës së gjithsejtë të dëmit të pësuar nga V01/04 dhe V2/04 deri V2/08. Në veçanti, Mbrojtja parashtron se Aktekspertiza e Mbrojtjes përfshin hollësi që nuk janë marrë parasysh në Aktekspertizën *Lerc*, si p.sh., ndër të tjera, ndikimet e periudhës së rindërtimit pas luftës, ndikimin e pandemisë KOVID-19 në ekonomi dhe funksionimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe zbatimin e tij konkretisht për personat që marrin pension invalidë. Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes, Aktekspertiza e Mbrojtjes do ta ndihmonte Trupin Gjyqësor të bëjë vlerësim më të saktë të shkallës së dëmeve materiale të pësuar nga viktimat.<sup>290</sup>

## 2. Vendimi i Trupit Gjyqësor

### a) Aspekte të përgjithshme

176. Fillimisht, Trupi Gjyqësor rikujton se z. Shala ka detyrimin e kompensimit të dëmit që u është shkaktuar të gjitha viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të krimeve për të cilat u shpall fajtor, pavarësisht nëse në shkaktimin e dëmit mund të kenë kontribuar dhe persona të tjerë.<sup>291</sup> Trupi Gjyqësor gjithashtu rikujton se mungesa e mjeteve financiare të personit të shpallur fajtor në kohën e lëshimit të urdhrit për

---

<sup>289</sup> KSC-BC-2020-04, F00711, Mbrojtja, *Kundërshtime të Mbrojtjes ndaj Pranueshmërisë së Aktekspertizës së Dëshmitarit Ekspert të Mbrojtësit të Viktimave dhe Kërkesë për Thirrjen e Dëshmitarit Ekspert për të Dëshmuar Gojarisht*, 8 nëntor 2023, konfidenciale, para. 17-20. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 nëntor 2023, [F00711/RED](#).

<sup>290</sup> KSC-BC-2020-04, F00716, Mbrojtja, *Parashtrim prej Mbrojtjes i një Aktekspertize në kuadër të Procesit të Zhdëmtimit*, 13 nëntor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, para. 8-9. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 nëntor 2023, [F00716/RED](#).

<sup>291</sup> *Shih* para. 99 më lart.

zhdëmtim nuk është pengesë që ai të ngarkohet me përgjegjësinë për zhdëmtim, dhe as i jep personit të shpallur fajtor të drejtën që të përfitojë ulje të kësaj përgjegjësie.<sup>292</sup>

177. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton parimin se përgjegjësia për zhdëmtim nga ana e personit të shpallur fajtor duhet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar.<sup>293</sup> Me fjalë të tjera, ajo duhet të pasqyrojë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat.<sup>294</sup> Rrjedhimisht, në përcaktimin e shumës së përgjegjësive financiare të z. Shala, Trupi Gjykses do të marrë parasysh shkallën dhe masën e dëmit të përcaktuar më lart.<sup>295</sup>

178. Duke rikujtuar se procesi i zhdëmtimit në DHS duhet të përqendrohet te viktimat dhe interesat e tyre,<sup>296</sup> Trupi Gjykses do të mbështetet kryesisht në Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim dhe, veçanërisht, në parashtrimet e tij lidhur me shumën e përgjegjësive financiare të z. Shala (dhe shumat përkatëse të zhdëmtimeve). Në këtë kontekst, për të vlerësuar shkallën dhe masën e dëmit në terma financiare, Trupi Gjykses do të marrë parasysh parashtrimet dhe materialet relevante të dorëzuara.<sup>297</sup>

179. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses thekson se nuk është kusht që të dorëzohen të dhëna për shpenzimet mjekësore ose për lloje të tjera të dëmit financiar ose pasuror, duke marrë parasysh veçanërisht: (i) kalimin e më se njëzet vjetëve që nga kryeja e krimeve; (ii) faktin se [REDAKTUAR] W04733, [REDAKTUAR] se nuk [REDAKTUAR] disa trajtime mjekësore për lëndimet fizike [REDAKTUAR], kryesisht

---

<sup>292</sup> *Shih* para. 84 më lart; *shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Repairation Order](#)), para. 209.

<sup>293</sup> *Shih* para. 81 më lart.

<sup>294</sup> *Shih* para. 82 më lart.

<sup>295</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Repairation Order](#)), para. 210.

<sup>296</sup> *Shih* para. 35 më lart.

<sup>297</sup> Trupi Gjykses thekson se disa dëme fizike, mendore, ose materiale mund të vlerësohen në terma financiarë (për shembull, shpenzimet për mjekim, pagat e humbura, shpenzimet për përkujdes në të ardhmen dhe dëmet e shkaktuara në pronë), ndërkohë që disa lloje të tjera dëmsh nuk mund të shprehen lehtë në vlera sasiore; *shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Repairation Order](#)), para. 211-212 dhe referencat aty.



nga frika ose për shkak të stigmatizimit;<sup>298</sup> dhe (iii) faktin se të paktën një viktimë ([REDAKTUAR]) pësoi dëm mendor që, sipas informacionit në dispozicion, nuk është trajtuar deri më sot.<sup>299</sup>

180. Gjithashtu, në përcaktimin e shumës së përgjegjesisë financiare të z. Shala dhe shumave gjegjëse të zhdëmtimit, Trupi Gjykses nuk do të tejkalojë atë që kërkohet në Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme.<sup>300</sup>

181. Si përfundim, duke zbatuar diskrecionin gjyqësor dhe në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit, Trupi Gjykses do të përcaktojë shumën për secilin lloj të dëmit – si dhe shumën e përgjithshme të përgjegjesisë financiare të z. Shala – të cilat i gjykon të arsyeshme në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore, të cilat pasqyrojnë siç duhet të drejtat dhe interesat e viktimave, duke mbajtur parasysh të drejtat e personit të shpallur fajtor.<sup>301</sup>

#### b) Jurisprudenca ndërkombëtare

182. Pasi ka shqyrtuar me kujdes parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave dhe të Mbrojtjes në lidhje me jurisprudencën ndërkombëtare dhe, në veçanti, jurisprudencën e GJEDNJ-së, Trupi Gjykses konsideron se jurisprudenca e GJEDNJ-së mund të ofrojë njëfarë orientimi lidhur me metodologjinë për vlerësimin e masës dhe shkallës së dëmit në kontekstin e procesit aktual për zhdëmtim.

183. Gjithsesi, Trupi Gjykses konstaton se duhet bërë dallim midis akordimit të kompensimit të drejtë nga GJEDNJ-ja dhe proceseve për zhdëmtim në DHS, pasi kompensimi i drejtë ka të bëjë me përgjegjësinë e shteteve për shkeljen e të drejtave të njeriut të individëve. Rrjedhimisht, ndonëse jurisprudenca dhe praktikat e GJEDNJ-

---

<sup>298</sup> Shih *gjithashtu* para. 104 dhe 134 më lart.

<sup>299</sup> Shih [REDAKTUAR]; *shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 212.

<sup>300</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 213 dhe referencat aty.

<sup>301</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 214 dhe referencat aty.

së përmbajnë parime të dobishme për vlerësimin e dëmit mendor dhe material, relevanca e tyre për përcaktimin prej Trupit Gjykses të shkallës së përgjegjësisë së z. Shala për zhdëmtime mbetet e kufizuar.

c) Legjislacioni dhe Udhëzuesi i Kosovës

184. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se legjislacioni aktual i Kosovës ofron një tregues se çfarë konsiderohet nivel proporcional zhdëmtimi për dëmin e shkaktuar si rezultat i luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, edhe pse në këto ligje nuk trajtohet dëmi konkret i pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses do ta marrë parasysh legjislacionin e Kosovës – si pikë referimi – për të përcaktuar shumën e zhdëmtimit që gjykohet e arsyeshme në kontekstin e Kosovës.<sup>302</sup>

185. Më konkretisht, Trupi Gjykses do të marrë parasysh ligjet në vijim: (i) Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, të 8 dhjetorit 2011<sup>303</sup> (Ligji nr. 04/L-054), ndryshuar më pas me Ligjin nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, të 20 marsit 2014<sup>304</sup> (Ligji nr. 04/L-172), në të cilin u përfshinë edhe viktimat e dhunës seksuale; dhe (ii) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës të Ushtrisë

---

<sup>302</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 217-218.

<sup>303</sup> [Law No. 04/L-054 on the Status and Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of the Kosovo Army, Civilian Victims of War and their Families](#), ((Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre), 8 dhjetor 2011.

<sup>304</sup> [Law No. 04/L-172 on Amending and Supplementing the Law No. 04/L-054 on the Status and the Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Sexual Violence Victims of the War, Civilian Victims and their Families](#), (Ligji nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre), 20 mars 2014.

Çlirimtare të Kosovës, të 23 prillit 2014<sup>305</sup> (Ligji nr. 04/L-261), ndryshuar më pas me Ligjin nr. 05/L-141 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të 14 prillit 2017<sup>306</sup> (Ligji nr. 05/L-141).<sup>307</sup>

186. Trupi Gjykses vëren se këto ligje rregullojnë në mënyrë të veçantë të drejtat dhe përfitimet që akordohen për veteranët dhe civilët e dëmtuar në kontekstin e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, ose për ata që kontribuan me pjesëmarrjen e tyre në këtë luftë, si edhe për anëtarët e familjeve të anëtarëve të UÇK-së dhe të civilëve që humbën jetën ose u zhdukën. Përfitimet e disponueshme ndryshojnë në varësi të kategorisë së cilës i përket personi dhe përfshijnë që nga pensionet mujore deri te përkujdesja dhe ndihma në institucione rezidenciale, rehabilitim mjekësor dhe fizik, shërbime shëndetësore jashtë shtetit, riaftësim profesional, përparësi në punësim, ndihma për strehim, bursa për shkollim të mesëm dhe universitar dhe lirim nga pagesa e tatimeve.<sup>308</sup> Përfitimet e përcaktuara në këto ligje nuk zbatohen në mënyrë prapavepruese.<sup>309</sup>

187. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se Ligji nr. 04/L-172, me të cilin u ndryshua Ligji nr. 04/L-054 për të përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale, sugjeron se Kosova aspiron t'u ofrojë mbështetje të gjitha viktimave të dëmtuara gjatë luftës së viteve 1998-1999. Megjithatë, përdorimi i fjalës "armik" në të gjithë tekstin e ligjit duket se përjashton viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore, pasi këto viktima e kanë

<sup>305</sup> [Law No. 04/L-261 on Kosovo Liberation Army War Veterans](#), (Ligji nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), 23 prill 2014.

<sup>306</sup> [Law No. 05/L-141 on Amending and Supplementing the Law No. 04/L-261 on Kosovo Liberation Army War Veterans](#), (Ligji nr. 05/L-141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), 14 prill 2017.

<sup>307</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 219.

<sup>308</sup> *Shih* nenet 5-15 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) dhe nenet 6-7 të Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)); nenet 23-33 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

<sup>309</sup> *Shih* nenin 22(2) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)); nenin 39(2) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)); *shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 220.

pësuar dëmin nga anëtarë të UÇK-së dhe jo nga forcat e “armikut”, d.m.th. forcat serbe.<sup>310</sup>

188. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se, në thelb, ky legjislacion synon të zhdëmtojë dëmin e pësuar nga personat gjatë luftës së viteve 1998-1999, ose të ndihmojë ata që kontribuan me pjesëmarrjen e tyre në luftë, Trupi Gjykses konstaton se shifrat e mëposhtme kanë rëndësi relative në përcaktimin e përgjegjësisë financiare të z. Shala për zhdëmtime. Trupi Gjykses do të marrë gjithashtu parasysh faktin se, sipas këtyre ligjeve, krahas pensioneve, përfituesit kanë të drejtë edhe për ndihma të tjera (të konsiderueshme).<sup>311</sup>

189. Sipas Ligjit nr. 04/L-054, pensionet mujore për “invalidin e luftës së UÇK-së”<sup>312</sup> shkojnë nga 255 euro (me dëmtim trupor mbi 31-40%) deri në 358.50 euro (me dëmtim trupor mbi 80%).<sup>313</sup> Pensionet mujore për “invalidin civil të luftës”<sup>314</sup> shkojnë nga 96 euro (me dëmtim trupor mbi 40-60%) deri në 122 euro (me dëmtim trupor mbi 80%).<sup>315</sup> Anëtarët e familjes së ngushtë të viktimës civile<sup>316</sup> kanë të drejtën të përfitojnë pension

<sup>310</sup> Shih nenin 3(1.7) dhe (1.10 dhe 1.12.) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)); shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 221.

<sup>311</sup> Shih nenet 9-11, 13-14 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)); nenet 6-7 të Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)); nenet 23-33 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)); shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 222.

<sup>312</sup> Neni 3(1.7) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), i ndryshuar nga Ligji nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)), përcakton se “invalid i luftës së UÇK-së” është “luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (i burgosuri) i UÇK-së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku dhjetë për qind (10%)”.

<sup>313</sup> Shih Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)). Invalidi i UÇK-së me shkallë invaliditeti 10 deri 19% nuk e gëzon pensionin invalidor personal (neni 10(4) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#))).

<sup>314</sup> Neni 3(1.8) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) përcakton se “Invalidi civil i luftës është personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40% si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së fituar në burgjet apo kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë, prej datës 27.02.1998 deri më datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40% si pasojë e mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”.

<sup>315</sup> Shih Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)).

<sup>316</sup> Sipas nenit 3(1.10) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), “Viktima civile e luftës” përcaktohet si “person i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut brenda periudhës 27.02.1998 deri më datën 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”. Neni 3(1.12) i Ligjit nr. 04/L-054

mujor familjar në shumën 135 euro (si dhe përfitime të tjera).<sup>317</sup> Sipas Ligjit nr. 04/L-261, veteranët e papunë <sup>318</sup> që nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ndonjë skemë tjetër pensioni, si p.sh. për lëndime të pësuar gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë,<sup>319</sup> kanë të drejtën e një pensioni mujor në shumën 170 euro.<sup>320</sup> Trupi Gjykses thekson se ndërsa viktimat e forcave të “armikut” kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin – sikurse tregojnë edhe llogaritjet e bëra në Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*<sup>321</sup> - pensione që arrijnë në dhjetëra mijëra euro që prej miratimit të legjislacionit të lartpërmendur, viktimat e krimeve të kryera nga anëtarët e UÇK-së në kontekstin e

---

([Law No. 04/L-054](#)) e përcakton “pengun civil të luftës” si “person civil, i cili gjatë luftës është arrestuar dhe internuar në kampet e armikut së paku tre (3) ditë, përkatësisht shtatëdhjetë e dy (72) orë”. Neni 3(1.14) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) e përcakton “personin civil të zhdukur” si “person vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999”. Sipas nenit 3(1.15) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), me “anëtarë të familjes së ngushtë” nënkuptohen “bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesorë, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtira si dhe bashkëshorti/bashkëshortja jashtëmartesore”. Rrjedhimisht, përdorimi i termit “armik” dhe përkufizimi i anëtarëve të familjes së ngushtë në këtë rast përjashtojnë viktimat e drejtpërdrejta dhe viktimat e tërthorta.

<sup>317</sup> *Shih* nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) dhe Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)).

<sup>318</sup> Sipas nenit 3(1.3) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-054](#)), veteran i UÇK-së është një “pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Kosovës” dhe në këtë kategori përfshihen “invalidi i luftës së UÇK-së”, “veterani luftëtar i UÇK-së”, “i internuari i UÇK-së”, “pjesëtari i UÇK-së”, “pjesëmarrësi i luftës” dhe “ushtari i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së”. *Shih* nenet 16(4) dhe 18 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

<sup>319</sup> *Shih* nenin 2(2) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

<sup>320</sup> Siç u përmend më lart, Ligji nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-261](#)) u ndryshua më pas me Ligjin nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)). Neni 16A i Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)) tani përcakton tri kategori të veteranëve:

- “1.1. Kategoria e parë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
- 1.2. Kategoria e dytë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
- 1.3. Kategoria e tretë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 marsit 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës”.

Veterani i kategorisë së parë përfiton 250 euro, veterani i kategorisë së dytë 170 euro dhe veterani i kategorisë së tretë 120 euro.

<sup>321</sup> *Shih* Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 223-226.

konfliktit të armatosur në Kosovë janë përjashtuar nga përfitimi i këtyre pensioneve dhe i ndihmave të tjera (të konsiderueshme).

190. Sa i përket Udhëzuesit të Kosovës, Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtësin e Viktimave se ai përmban informacion të dobishëm për mënyrën se si akordohet kompensimi në Kosovë, veçanërisht në lidhje me dëmin fizik dhe/ose mendor. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se Udhëzuesi i Kosovës, në kuptimin e ngushtë të fjalës, ofron udhëzime për paditë civile në gjykatat e Kosovës dhe si i tillë nuk zbatohet drejtpërdrejt në proceset për zhdëmtim lidhur me krimet e luftës/krimet kundër njerëzimit në DHS. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e konsideron atë relevant për aq sa ai ofron llogaritje të dobishme të shumave monetare për dëmin e pësuar, në kontekstin ekonomik aktual në Kosovë.

d) Aktekspertizat

191. Fillimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja kërkuar pranimin si prova përkatësisht të Aktekspertizës *Lerc* dhe Aktekspertizës së Mbrojtjes. Trupi Gjykses rikujton se, sikurse u është njoftuar më parë Mbrojtësit të Viktimave dhe Mbrojtjes, të dyja Aktekspertizat janë në dispozicion të Trupit Gjykses.<sup>322</sup> Trupi Gjykses dëshiron të sqarojë se të dyja Aktekspertizat u dorëzuan vetëm në kuadër të procesit për zhdëmtim në këtë çështje gjyqësore, d.m.th. sipas rregullës 168 të Rregullores. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton se rregulla 168 e Rregullores është rregulla *lex specialis* që zbatohet në kontekstin konkret për zhdëmtimet, ndërsa rregulla 149 e Rregullores, që trajton në përgjithësi dëshmitarët ekspertë, nuk zbatohet.<sup>323</sup> Pra, në Rregullore parashikohet qartë se në parim, në

---

<sup>322</sup> *Shih* mesazhet me postë elektronike të Trupit Gjykses I, *Sqarim i Statusit të Aktekspertizës*, 1 mars 2024, në orën 12:10.

<sup>323</sup> *Shih* KSC-BC-2020-04, F00749, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat F00716, F00725 dhe F00731 të Mbrojtjes për Aspekte lidhur me Eksperten e Mbrojtjes për Dëmin Material*, 13 dhjetor 2023, konfidencial, para. 22. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00749/RED](#); *shih* gjithashtu KSC-BC-2020-05, F00425, Trupi Gjykses I, [Decision appointing a financial expert and setting out further procedural steps with regard to reparation proceedings](#), (Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e

kontekstin e procesit për zhdëmtim, Trupi Gjykses i merr dhe i vlerëson dëshmitë e ekspertëve vetëm me shkrim. Gjithashtu, në ndryshim nga rregulla 149(4) të Rregullores,<sup>324</sup> rregulla 168 e Rregullores nuk kërkon që Trupi Gjykses të marrë vendime për pranueshmërinë e një aktekspertize që ka të bëjë vetëm me zhdëmtime. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk do të marrë vendim në lidhje me pranueshmërinë e secilës aktekspertizë, por do t'u referohet përmbajtjes së tyre dhe kundërshtimeve ndaj tyre, sipas rastit.

192. **Aktekspertiza Lerc.** Trupi Gjykses vë në dukje se në Aktekspertizën *Lerc* bëhen vlerësime të përafërta të dëmit material të pësuar nga V01/04 dhe V02/04 - V08/04. Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se vlerësimet në Aktekspertizën *Lerc* nuk janë proporcionale me jurisprudencën ekzistuese të DHS-së dhe me legjislacionin dhe Udhëzuesin e Kosovës. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se Aktekspertiza *Lerc* mund të bëjë vetëm vlerësimin e përafërt të dëmit material dhe jo përlllogaritjen e saktë e tij, sepse analiza aty bazohet në të dhëna statistikore, një pjesë e të cilave nuk burojnë nga Kosova.<sup>325</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykses do t'i marrë parasysh këto vlerësime si pikë reference, por nuk është i detyruar t'u përmbahet atyre në përcaktimin e zhdëmtimit.

193. **Aktekspertiza e Mbrojtjes.** Trupi Gjykses pranon se Aktekspertiza e Mbrojtjes pasqyron më nga afër legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe vlerësimet në të bazohen në të dhëna statistikore që burojnë nga Kosova.<sup>326</sup> Megjithatë, në Aktekspertizën e Mbrojtjes ka një numër mangësish të rëndësishme të cilat kanë ndikim mbi kuadrin

---

Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit), 1 qershor 2022, publik, para. 10.

<sup>324</sup> *Shih* KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, [Decision on the submission and the admissibility of evidence](#), (Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave), 25 gusht 2021, publik, para. 24; *shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-04, F00461, Trupi Gjykses I, [Decision on the submission and admissibility of non-oral evidence](#), (Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave Jogojore), 17 mars 2023, publik, para. 29.

<sup>325</sup> *Shih p.sh.* Aktekspertizën *Lerc*, f. 18-23; 33; 41; *shih gjithashtu* Përgjigjet e Ekspertit të Mbrojtësit të Viktimave ([Victims' Counsel Expert Answers](#)).

<sup>326</sup> Sidomos sa i përket sistemit të pensioneve, ndihmave sociale për personat me aftësi të kufizuara dhe shkallës së vdekshmërisë në Kosovë, *shih p.sh.* Aktekspertizën e Mbrojtjes, në veçanti f. DPS01627, DPS01633, DPS01637, DPS01641.

dhe vlefshmërinë e konstatimeve të bëra, sepse në të: (i) pretendohet se mungon lidhja shkakësore<sup>327</sup> midis krimeve të kryera ndaj V01/04-ës më 1999 dhe dëmit material të pësuar në formën e humbjes së të ardhurave në vitet në vijim;<sup>328</sup> (ii) keqinterpretohet numri i përgjithshëm i viktimave të tërthorta të lidhura me W04733-shin, sikur janë katër në vend të shtatë, gjë që ndikon në llogaritjen e shumës së gjithsejtë të dëmit material të pësuar prej tyre;<sup>329</sup> (iii) paraqitet se viktimat V02/04-V08/04 pësuan vetëm dëm jomaterial dhe bëhet llogaritja e atij dëmi;<sup>330</sup> (iv) nuk bëhet asnjë vlerësim i dëmit të mundshëm material që pësuan V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 si pasojë e humbjeve në të ardhura të W04733-shit pas krimeve të kryera kundër tij;<sup>331</sup> dhe (v) llogaritet dëmi jomaterial që pësoi V01/04 duke marrë parasysh fakte që nuk kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore, ndonëse u njoftua që kuadri i kësaj Aktekspertize kufizohej në humbjen e të ardhurave.<sup>332</sup> Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykyes nuk mund të mbështetet në vlerësimet e bëra në Aktekspertizën e Mbrojtjes.

<sup>327</sup> Do të kishte qenë më mirë që ekspertja e Mbrojtjes ta kufizonte analizën e saj në llogaritjen e humbjes në të ardhura dhe të mos përpiquej të vërtetonte ekzistencën e lidhjes shkakësore që është vetëm në kompetencën e Trupit Gjykyes.

<sup>328</sup> *Shih p.sh.* Aktekspertizën e Mbrojtjes, f. DPS01631, DPS01637, DPS01640, DPS01643; KSC-BC-2020-04, F00736/A01, Mbrojtja, *Parashtrim nga Mbrojtja i Përgjigjeve të Ekspertes ndaj Pyetjeve me Shkrim të Mbrojtësit të Viktimave*, konfidencial, 6 dhjetor 2023, f. 2, 6-7 (Përgjigjet e Ekspertes së Mbrojtjes). Në lidhje me këtë, Trupi Gjykyes rikujton se është bindur, bazuar në tërësinë e gjasave, se krimet e kryera nga z. Shala kundër V01/04-ës më 1999 shkaktuan drejtpërdrejt dëmin material të pretenduar në formën e humbjes në të ardhura, *shih* para. 119-121 më lart.

<sup>329</sup> *Shih p.sh.* Aktekspertizën e Mbrojtjes, f. DPS01641- DPS01642, ku thuhet se llogaritjet kanë lidhje vetëm [REDAKTUAR]; Përgjigjet e Ekspertes së Mbrojtjes, f. 3, 8-9.

<sup>330</sup> Aktekspertiza e Mbrojtjes, f. DPS01641-DPS01642; Përgjigjet e Ekspertes së Mbrojtjes, f. 3, 9 (përgjigjet 4 dhe 25). Trupi Gjykyes vëren gjithashtu se nuk është roli i ekspertës së Mbrojtjes që të bëjë konstatime në lidhje me ekzistencën e dëmit. Do të kishte qenë më mirë që ekspertja e Mbrojtjes të bënte supozime bazuar në ekzistencën e dëmit.

<sup>331</sup> Trupi Gjykyes gjykon Aktekspertiza e Mbrojtjes do ta kishte ndihmuar atë më shumë në këtë aspekt, në qoftë se në të do të ishin bërë vlerësime, qoftë edhe të përafërta, të dëmit të mundshëm material, në vend që të vihej në dyshim ekzistenca e vetë dëmit. Në vend kësaj, Aktekspertiza e Mbrojtjes përmban vlerësime të dëmit jomaterial, të cilat janë jashtë kuadrit të Aktekspertizës.

<sup>332</sup> Aktekspertiza e Mbrojtjes, f. DPS01642; [Victims' Counsel Questions for Defence Expert](#) (Pyetje të Mbrojtësit të Viktimave për Eksperten e Mbrojtjes), para. 5, dhe KSC-BC-2020-04, F00728/A01, Mbrojtësi i Viktimave, *Pyetje të Mbrojtësit të Viktimave për Eksperten e Mbrojtjes*, 27 nëntor 2023, konfidenciale, pyetja 19, f. 4; për përgjigjen, *shih* Përgjigjet e Ekspertes së Mbrojtjes, f. 7.



Rrjedhimisht, ashtu si me Aktekspertizën *Lerc*, Trupi Gjykses do t'i marrë parasysh ato si pikë reference në përcaktimin e zhdëmtimit.

e) Diskutim

194. Duke pasur parasysh kontekstin ekonomik në Kosovë, legjislacionin relevant në Kosovë dhe bazuar në praktikën e zbatuar në DHS në Çështjen *Mustafa*, Trupi Gjykses konstaton si vijon.

195. **V01/04.** Trupi Gjykses rikujton se V01/04 pësoi dëm fizik afatgjatë si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës, për të cilat z. Shala u shpall fajtor.<sup>333</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se kompensimi në shumën 10.000 euro i kërkuar nga Mbrojtësi i Viktimave është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm.

196. V01/04 gjithashtu pësoi dëm mendor afatgjatë si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>334</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se nga dëmi mendor që pësoi si rezultat i krimeve të kryera kundër tij, V01/04 nuk mund të punonte më dhe pati vështirësi në jetën shoqërore dhe familjare.<sup>335</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se kompensimi në shumën 30.000 euro i kërkuar nga Mbrojtësi i Viktimave është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm. Ndonëse asnjë shumë parash nuk mund të shuajë çfarë ndodhi, [REDAKTUAR], ky kompensim shërben si njohje e vuajtjes së shumëfishtë dhe afatgjatë që pësoi V01/04 [REDAKTUAR] si pasojë e ndalimit dhe torturimit të tij nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala; por edhe sepse [REDAKTUAR].<sup>336</sup>

197. Sa i përket dëmit material, sipas Aktekspertizës *Lerc*, humbjet në të ardhura të V01/04-ës shkojnë nga [REDAKTUAR] deri në [REDAKTUAR].<sup>337</sup> Në Aktekspertizën e Mbrojtjes, duke mbajtur parasysh të gjitha mangësitë e përshkruara më lart, humbjet

---

<sup>333</sup> *Shih* para. 103-106 më lart.

<sup>334</sup> *Shih* para. 107-116 më lart.

<sup>335</sup> *Shih* para. 113, 115 më lart.

<sup>336</sup> *Shih* Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 827.

<sup>337</sup> Aktekspertiza *Lerc*, f. 3.

në të ardhura vlerësohen në shumën [REDAKTUAR].<sup>338</sup> Trupi Gjykses vëren se kompensimi në shumën 60.000 euro i kërkuar nga Mbrojtësi i Viktimave për V01/04-ën është konsiderueshëm më i ulët se konstatimet në Aktekspertizën e Mbrojtjes dhe në Aktekspertizën *Lerc*. Po kështu, Trupi Gjykses vlerëson se këto shuma nuk janë të tepruara kur krahasohen me përfitimet e disponueshme sipas legjislacionit të Kosovës.<sup>339</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se kompensimi në shumën 60.000 euro i kërkuar nga Mbrojtësi i Viktimave është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm.

198. V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04. Sa u përket viktimave të tërthorta, Trupi Gjykses gjykon se shumata e kërkua nga Mbrojtësi i Viktimave (10.000 euro për V03/04-ën dhe 8.000 euro për person për V02/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe V08/04-ën) për kompensimin e dëmit mendor të pësuar nga këto viktima, janë proporcionale në raport me shumën e kërkuar për V01/04-ën, ndonëse, në mënyrë të kuptueshme, më të ulëta.<sup>340</sup> Këto shifra janë gjithashtu brenda shkallëzimit të zhdëmtimeve që iu dhanë viktimave të tërthorta në çështjen gjyqësore *Mustafa*.<sup>341</sup> Trupi Gjykses gjithashtu pranon argumentin e Mbrojtësit të Viktimave se, ndonëse shuma e kërkuar veçanërisht për V03/04-ën i tejkalon paksa shumata e sugjeruara në Udhëzuesin e Kosovës, pesha e krimeve të kryera kundër W04733-shit dhe shkalla e dëmit të pësuar nga familja për ligjin shumata e propozuara.<sup>342</sup> Së fundi, për arsyet e dhëna nga Mbrojtësi i Viktimave,<sup>343</sup> Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të bëhet dallim midis shumës që do t'i jepet V03/04-ës (gruaja e W04733-shit) dhe V02/04-ës, V04/04-ës, V05/04-ës, V06/04-ës, V07/04-ës dhe V08/04-ës ([REDAKTUAR]) për dëmin mendor që pësuan.

---

<sup>338</sup> Aktekspertiza e Mbrojtjes, f. DPS01640.

<sup>339</sup> *Shih* para. 189-190 më lart.

<sup>340</sup> *Shih* para. 164 më lart. Trupi Gjykses vë në dukje se V01/04 pësoi dëm mendor si viktimë e drejtpërdrejtë dhe viktimë e tërthortë (edhe si rezultat i krimit të vrasjes së paligjshme).

<sup>341</sup> [Mustafa Reparation Order](#), (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 248.

<sup>342</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 47.

<sup>343</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 45, 58 A)ii).

199. Në lidhje me dëmin material të pësuar nga V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 si rezultat i krimeve të kryera kundër W04733-shit, Trupi Gjykses rikujton se, sipas Aktekspertizës *Lerc*, humbja në të ardhura vlerësohet në shumën [REDAKTUAR].<sup>344</sup> Në Aktekspertizën e Mbrojtjes nuk bëhet ndonjë vlerësim relevant në lidhje me këtë aspekt, për shkak se aty përmendet vetëm vlerësimi i dëmeve jomateriale për një numër të pasaktë viktimash të tërthorta.<sup>345</sup> Vlerësimet në Aktekspertizën *Lerc* nuk përfshijnë shpenzimet mjekësore ose shpenzimet për trajtimin mjekësor të W04733-shit me kalimin e viteve si rezultat i krimeve të kryera kundër tij në FMK. Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me këtë aspekt është që të gjithë familjes t'i akordohet kolektivisht shuma prej 50.000 eurosh, që pasqyron humbjen në të ardhura të W04733-shit dhe (pjesërisht) shpenzimet mjekësore të paraqitura nga familja e W04733-shit.<sup>346</sup>

200. Trupi Gjykses konstaton se kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për një shumë përfundimtare prej 50.000 eurosh është vlerësim i moderuar i dëmit material të pësuar nga familja e W04733-shit për arsyet në vijim: (i) pjesa e shumës së kërkuar që i përket humbjes në të ardhura *vetëm* për W04733-shin (d.m.th. 20.000 euro) është më e ulët se vlerësimet në Aktekspertizën *Lerc*; (ii) vlerësimet në Aktekspertizën *Lerc* nuk marrin parasysh humbjen në të ardhura të vetë viktimave të tërthorta (p.sh. faktin që vajzave të W04733-shit iu desh të ndërprisnin shkollimin dhe [REDAKTUAR] sepse familja brengosej për sigurinë e tyre; dhe faktin që edhe [REDAKTUAR] mundësi punësimi për shkak të stigmatizimit që përjetoi familja si rezultat i ndalimit të W04733-shit në FMK);<sup>347</sup> dhe (iii) si V03/04 dhe W04733 dhanë shifrat e llogaritura për shpenzimet

---

<sup>344</sup> Aktekspertiza *Lerc*, f. 17.

<sup>345</sup> Aktekspertiza e Mbrojtjes, f. DPS01641-DPS01642.

<sup>346</sup> [Victims' Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 53-54.

<sup>347</sup> *Shih* para. 143 më lart.

mjekësore për [REDAKTUAR]<sup>348</sup> – dhe kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave është brenda këtyre shifrave. Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se dëmi fizik dhe mendor i pësuar nga W04733 pati pasoja afatgjata,<sup>349</sup> ndonëse pranon se jo të gjitha aspektet e përkeqësimit të shëndetit të W04733-shit gjatë viteve në vijim ishin rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të kryera kundër tij në FMK. Megjithatë, duke pasur parasysh brutalitetin e atyre krimeve dhe gjendjen e tij kur u kthye në shtëpi pas ndalimit në FMK, Trupi Gjykses konstaton se mundësia është që efekti i tyre në shëndetin e tij në përgjithësi [REDAKTUAR].

201. Së fundi, Trupi Gjykses merr parasysh kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave se për dëmin material të shkaktuar nga humbja në të ardhura dhe shpenzimet mjekësore, duhet t'i akordohet zhdëmtim kolektiv të gjithë anëtarëve të familjes, dhe t'u shpërndahet në përputhje me udhëzimet e tyre. Sikurse theksohet më lart, zhdëmtimet duhet të kenë në qendër viktimat dhe interesat e tyre, që do të thotë se "interesat, nevojat, pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave duhet të jenë forca shtytëse e procesit të vendimmarrjes për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zhdëmtimet".<sup>350</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullën 168 të Rregullores, viktimave mund t'u akordohen zhdëmtime "kolektivisht ose individualisht" dhe se këto dy lloj zhdëmtimesh nuk përjashtojnë njëri-tjetrin dhe mund të akordohen njëkohësisht.<sup>351</sup> Termi zhdëmtime kolektive mund t'u referohet llojit ose përfituesve të tyre, që mund të jetë një komunitet ose grup, dhe ato dallojnë nga zhdëmtimet individuale për faktin se përfitues të tyre janë grupi ose kategoria e personave që kanë pësuar dëm bashkërisht.<sup>352</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë shprehimisht se zhdëmtimi kolektiv mund t'i akordohet një grupi të caktuar – familjes në çështjen

---

<sup>348</sup> Shih *Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim* ([Victims' Counsel Reparations Request](#)), para. 52: W04733 tha se [REDAKTUAR]; ndërsa gruaja e tij dëshmoi se shpenzimet e përgjithshme për trajtimin mjekësor të W04733-shit, [REDAKTUAR], shkonin deri në 150.000 euro.

<sup>349</sup> Shih para. 130 dhe 135 më lart.

<sup>350</sup> Shih para. 35 më lart.

<sup>351</sup> Shih para. 71 më lart.

<sup>352</sup> Shih para. 73 më lart.

gjqësore aktuale – veçanërisht nëse ky grup ka pësuar dëm bashkërisht. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të akordojë zhdëmtim kolektiv në lidhje me dëmin e pësuar nga familja e W04733-shit, sepse të gjithë anëtarët e familjes kanë marrë pjesë në mënyra të ndryshme në përballimin e kostos së humbjeve në të ardhura si dhe shpenzimet për trajtimin mjekësor të W04733-shit dhe, për rrjedhojë, kanë pësuar dëm bashkërisht.<sup>353</sup> Së fundi, Trupi Gjykses i kushton vëmendje të veçantë faktit se e gjithë familja pësoi dëm mendor dhe material si rezultat i krimeve të kryera kundër W04733-shit dhe stigmatizimit dhe etiketimit si “tradhtar”, “spiun”, ose “bashkëpunëtor i serbëve”, sepse të gjithë anëtarët e familjes shiheshin “si familje spiunësh nga disa persona, ose konsideroheshin të tillë” për shkak të asaj që i ndodhi W04733-shit.<sup>354</sup> Bashkëshortja e W04733-shit e theksoi qartë në dëshminë e saj se dëmi që iu shkaktua familjes ishte i tmerrshëm dhe me pasoja afatgjata: “Me strese, unë dhe gjithë fëmijët. Shumë kohë, shumë kohë, as sot nuk mund t’i shlyjmë ato brenga nga që çka kemi përjetue”.<sup>355</sup>

202. Trupi Gjykses vëren se modalitetet se si do të kenë qasje në këtë zhdëmtim kolektiv V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 do të përcaktohen në fazën e zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim dhe bazuar në udhëzimet e tyre. Në rast se do të lindin mosmarrëveshje me tyre në momentin e pagesës së këtij zhdëmtimi kolektiv, Mbrojtësi i Viktimave duhet t’i drejtohet Gjykatësit të Vetëm të caktuar nga Kryetarja e DHS-së në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit<sup>356</sup> për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

#### f) Përfundim

<sup>353</sup> [Victims’ Counsel Reparations Request](#), (Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim), para. 55.

<sup>354</sup> [REDAKTUAR] T. 29 mars 2023, publik, f. 912, rreshtat 19-21 (theksimi i shtuar); *shih* Pjesën V më lart, para. 143.

<sup>355</sup> [Trial Judgment](#), (Aktgjykimi), para. [REDAKTUAR] dhe referencat aty.

<sup>356</sup> *Shih* Pjesën VII më poshtë, ku trajtohet zbatimi i urdhrin për zhdëmtim.

203. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se shumat 10.000 euro për dëmin fizik, 30.000 euro për dëmin mendor dhe 60.000 euro për dëmin material, gjithsej 100.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga V01/04 dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

204. Po ashtu, Trupi Gjykues konstaton se shumat për dëmin mendor, prej 10.000 eurosh për V03/04-ën dhe 8.000 eurosh për person për V02/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe V08/04-ën, si edhe shuma prej 50.000 eurosh që i akordohet kolektivisht për dëm material viktimave V02/04-08/04, gjithsej 108.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat e tërthorta dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

205. Duke marrë parasysh të gjitha aspektet e lartpërmendura, shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke vendosur për aspektet për të cilat kishte mëdyshje në favor të personit të shpallur fajtor, dhe duke balancuar nevojën për saktësi në llogaritjen e shumave monetare me objektivin për akordimin pa vonesë të zhdëmtimeve, Trupi Gjykues përcakton se shuma e gjithsejtë e zhdëmtimit që ka përgjegjësinë ta paguajë z. Shala është 208.000 euro.

206. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues urdhëron z. Shala t'u paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:

- 100.000 euro V01/04-ës, për dëm mendor dhe material;
- 8.000 euro për person V02/04-ës, V04/04-ës, V05/04-ës, V06/04-ës, V07/04-ës dhe V08/04-ës për dëm mendor;
- 10.000 euro V03/04-ës për dëm mendor; dhe
- 50.000 euro kolektivisht V02/04-ës, V03/04-ës, V04/04-ës, V05/04-ës, V06/04-ës, V07/04-ës dhe V08/04-ës për dëm material.

207. Së fundi, Trupi Gjykues thekson se ky Urdhër për Zhdëmtim nuk del jashtë kuadrit të krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

## VII. VËNIA NË JETË DHE ZBATIMI I URDHRI PËR ZHDËMTIM

### A. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

208. Trupi Gjykses rikujton se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore përfundon me lëshimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim, në pajtim me nenin 33(1)(b) të Ligjit.<sup>357</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ka kompetencë të monitorojë dhe mbikëqyrë vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se në Ligj dhe Rregullore nuk specifikohet autoriteti që duhet të monitorojë dhe mbikëqyrë vënien në jetë dhe zbatimin e urdhrit për zhdëmtim.<sup>358</sup>

209. Trupi Gjykses gjithashtu është i mendimit se për të mundësuar një proces efikas dhe të shpejtë në dobi të viktimave, është i nevojshëm një autoritet gjyqësor për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim. Gjithashtu, Trupi Gjykses parashikon që gjatë zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, mund të lindin probleme të cilat duhet të zgjidhen nga një autoritet gjyqësor.<sup>359</sup>

210. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses fton Kryetaren e DHS-së, si personi përgjegjës për administrimin gjyqësor të DHS-së, të caktojë një Gjykatës të Vetëm, në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim, sikurse u veprua në kontekstin e zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*.<sup>360</sup>

---

<sup>357</sup> Në nenin 33(1)(b) të Ligji përcaktohet se: “Caktimi i gjyqtarit (gjyqtarëve) të trupit gjykses përfundon në ditën kur formohet paneli i Gjykatës së Apelit për të dëgjuar ankesën kundër aktgjykimit të tij apo nëse periudha kohore për ankesë skadon pa u paraqitur asnjë ankesë, përveç nëse trupi gjykses është njëkohësisht i përfshirë në procedura të tjera, me ç’rast caktimet e gjyqtarëve përfundojnë në kohën e përmbylljes së atyre procedurave” [theksimi i shtuar].

<sup>358</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 250.

<sup>359</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 251.

<sup>360</sup> KSC-BC-2020-05/R001, F00002, Kryetarja, [Decision Assigning a Single Judge](#), (Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm) 17 janar 2024, publik.

211. Zyra Administrative, si “përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e Dhomave të Specializuar, si dhe për të gjitha funksionet e nevojshme përkatëse” sipas nenit 34(1) të Ligjit, do të kryejë veprimet e nevojshme për vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, sipas udhëzimeve që jepen në këtë Urdhër ose, pas lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, nga Gjykatësi i Vetëm i caktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të tij.<sup>361</sup>

## B. FINANCIMI

### 1. Nga personi i shpallur fajtor

212. Siç u përcaktua më lart, z. Shala është përgjegjës për t’u paguar viktimave shumën 208.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar.<sup>362</sup>

213. Megjithatë, duke marrë parasysh se në këtë fazë Trupi Gjykses nuk ka asnjë të informacion nëse z. Shala është, ose do të jetë në gjendje ta paguajë shumën e akorduar viktimave në Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala i mungojnë mjetet financiare për pagimin e zhdëmtimeve.<sup>363</sup>

214. Gjithashtu, duke pasur parasysh se z. Shala duket – aktualisht – se nuk është në gjendje të paguajë shumën e zhdëmtimit, Trupi Gjykses është i mendimit se për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim duhet të përfshihen edhe aktorë të tjerë. Këta do të trajtohen në më poshtë.<sup>364</sup> Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykses fillimisht thekson se z. Shala mbetet përgjegjës për pagimin e të gjithë shumës së zhdëmtimit.<sup>365</sup> Rrjedhimisht, në rast se një shtet (si Kosova) ose një institucion tjetër ofron shumat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim në dobi të viktimave, kjo nuk e liron z. Shala nga përgjegjësia dhe ai do të vazhdojë të ketë detyrimin t’i kthejë ato shuma kur monitorimi i gjendjes së tij financiare do të zbulojë se ai zotëron mjetet financiare për

<sup>361</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 253.

<sup>362</sup> *Shih* para. 205 më lart.

<sup>363</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 258.

<sup>364</sup> *Shih* para. 215-238 më poshtë.

<sup>365</sup> *Shih* para. 205 më lart.



përmbushjen e këtij Urdhri për Zhdëmtim. Për këtë qëllim, Gjykatësi i Vetëm që do të caktohet për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim mund të vazhdojë të [REDAKTUAR] monitorojë në vijimësi gjendjen financiare të tij për zbatimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim.<sup>366</sup>

## 2. Nga Kosova

215. Trupi Gjykses rikujton se, në kontekstin e procesit *Mustafa* ai i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës të dorëzonte informacione konkrete lidhur me mundësinë që viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së të përfitojnë: (i) nga fondet ekzistuese për kompensimin e viktimave; (ii) ose, nëse kjo është e mundur, nga një fond i krijuar rishtas dhe i financuar nga buxheti i Kosovës.<sup>367</sup>

a) Fondet ekzistuese për kompensimin e viktimave në Kosovë

216. Trupi Gjykses rikujton se, sikurse konfirmoi Ministria e Drejtësisë së Kosovës në kontekstin e procesit *Mustafa*,<sup>368</sup> viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së mund t'u akordohet kompensim ose dëmshpërblim nga programi për kompensimin e viktimave të krimit, krijuar në bazë të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimeve (përkatësisht, Ligji nr. 05/L-036 dhe Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit), nëse vërtetohet se personi i shpallur fajtor

---

<sup>366</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 259 dhe referencat aty.

<sup>367</sup> KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe ku Kërkohet Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial, para. 50(f) (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00310/RED](#)) dhe më pas, KSC-BC-2020-05, F00396, Trupi Gjykses I, *Order requesting the Ministry of Justice of Kosovo to provide further submissions*, (Urdhër drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për Parashtrime të Mëtejshme), 25 prill 2022, publik.

<sup>368</sup> KSC-BC-2020-05, F00407/eng, Ministria e Drejtësisë e Kosovës, *Response to your Document KSC-BC-2020-05* (Përgjigje në lidhje me Shkresën KSC-BC-2020-05), (Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), 13 maj 2022, publik, f. 1, ku Ministria thotë se “Viktimat e krimit, duke përfshirë edhe viktimat nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara [...] mund të përfitojnë kompensimin apo dëmshpërblimin nga Fondi i Kompensimit të Viktimave të Kosovës”.

nuk është në gjendje të paguajë tërësisht ose pjesërisht shumën e dëmshpërblimit të akorduar.<sup>369</sup>

217. Në kontekstin e procesit *Mustafa*, Ministria e Drejtësisë informoi Trupin Gjykses se viktimat që parashtrajnë kërkesa për kompensim mund të mbeten anonime, por vetëm “përtej personave kompetentë që merren me administrimin dhe ekzekutimin e kërkesës për kompensim”.<sup>370</sup> Administratorja e DHS-së nuk mund të jetë “e autorizuar e viktimës” dhe të paraqesë kërkesë për kompensim ose dëmshpërblim në emër të viktimave “për të shmangur çfarëdolloj elementi të konfliktit të interesit”, por viktimat mund të kërkojnë ndihmën e mbrojtësit të viktimave që e ka autorizuar me akt përfaqësimi për të vepruar në emër të tij ose të saj.<sup>371</sup>

218. Trupi Gjykses thekson se Ligji nr. 05/L-036 u shfuqizua dhe u zëvendësua me Ligjin nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të 2 nëntorit 2022 (Ligji nr. 08/L-109).<sup>372</sup> Gjithsesi, Trupi Gjykses vë në dukje se parashtrimet e lartpërmendura të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës mbeten relevante në kontekstin e Ligjit nr. 08/L-109.

219. Fillimisht, Trupi Gjykses rithekson se, në bazë të nenit 23 të Ligjit, ai duhet të garantojë mbrojtjen e viktimave gjatë gjithë procesit gjyqësor, përfshirë gjatë procedurës së zhdëmtimit dhe zbatimit të çdo urdhri për zhdëmtim, pavarësisht nga forumi ku kryhet procedura e zhdëmtimit apo zbatimi i urdhrave për zhdëmtim.<sup>373</sup> Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta në lidhje me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHS-së dhe familjeve të tyre.<sup>374</sup> Ai gjithashtu rikujton

---

<sup>369</sup> [Mustafa Reparation Order](#), (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 261 dhe referencat aty.

<sup>370</sup> [Mustafa Reparation Order](#), (Urdhri për Zhdëmtim në Çështjen *Mustafa*), para. 262 dhe referencat aty.

<sup>371</sup> [Mustafa Reparation Order](#), (Urdhri për Zhdëmtim Çështjen *Mustafa*), para. 262 dhe referencat aty.

<sup>372</sup> [Law No. 08/L-109 on Crime Victim Compensation](#), (Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit), 2 nëntor 2022.

<sup>373</sup> *Shih* Rregullën 81(1) të Rregullores.

<sup>374</sup> [Trial Judgment](#), (Aktgjykimi), para. 96-97.

se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe ky Trup Gjykues urdhëruan masa mbrojtëse për viktimat, konkretisht që publikut të mos i bëhen të ditura emrat dhe të dhënat identifikuese të tyre.<sup>375</sup>

220. Në këto rrethana, nxjerrja e identitetit të viktimave për një numër të madh njerëzish, si p.sh. për Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit<sup>376</sup> dhe punonjësit e tij, shton rrezikun që identitetet e tyre t'i zbulohen – qëllimisht ose jo qëllimisht – publikut, përfshirë personave me synime të dëmshme. Sidoqoftë, Trupi Gjykues konstaton se në këto rrethana – të cilat krijohen jo për faj të tyre – nuk mund të pengojnë zhdëmtimin e viktimave.<sup>377</sup>

221. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues urdhëron Administratoren, në bashkërendimin me Mbrojtësin e Viktimave, të kërkojë në emër të viktimave kompensim nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në mënyrë që të ruhet anonimiteti i viktimave në fjalë dhe të garantohet mbrojtja e tyre. Trupi Gjykues është i mendimit se në këtë kontekst nuk lind asnjë konflikt interesi pasi Zyra Administrative është organ asnjës i DHS-së, mandati i së cilës është të administrojë dhe t'i shërbejë DHS-së, si dhe të kryejë të gjitha funksionet e tjera përkatëse në bazë të nenit 34(1) të Ligjit. Gjatë kryerjes së kësaj detyre, Administratorja dhe Mbrojtësi i Viktimave do t'i dorëzojnë Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit vetëm informacion publik në lidhje me viktimat.<sup>378</sup> Në qoftë se është e nevojshme, Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, mund të vërtetojë se viktimat në emër të të cilave po bëjnë kërkesë Administratorja/Mbrojtësi i Viktimave në Komisionin për Kompensimin e

---

<sup>375</sup> Shih KSC-BC-2020-04, F00036, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë në Lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 17 maj 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 5-6. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F00036/CONF/RED; [REDAKTUAR].

<sup>376</sup> Trupi Gjykues vëren se në bazë të neneve 3(1.12), 21 dhe 23 të Ligjit nr. 08/L-109, autoriteti vendimmarrës në kuadër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

<sup>377</sup> Shih, *ngjashëm*, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 265.

<sup>378</sup> Shih, *ngjashëm*, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 266.

Viktimave të Krimit, janë po ato që u është akorduar kompensim në këtë Urdhër për Zhdëmtim.

222. Në pajtim me nenin 53(2) të Ligjit, sipas të cilit çdo person fizik, korporatë, autoritet apo subjekt tjetër në Kosovë duhet të veprojë në përputhje me çdo urdhër të lëshuar nga DHS-ja, Trupi Gjykes kërkon nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit t'u kushtojë vëmendjen e duhur kërkesës së viktimave për kompensim, mbi bazën e informacionit të dhënë nga Administratorja dhe Mbrojtësi i Viktimave, si dhe mbi bazën e versionit të redaktuar publik të Urdhrit për Zhdëmtim. Në këtë aspekt, Trupi Gjykes thekson se versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim i ofron Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit informacionin e duhur në mbështetje të kërkesave të viktimave për kompensim, sikurse janë konstatimet e Trupit Gjykes në lidhje me: (i) dëmin e pësuar nga secila viktimë si pasojë e krimeve të kryera nga z. Shala; (ii) shkallën e përgjegjësisë së z. Shala për zhdëmtimet dhe kompensimin që duhet t'u akordohet viktimave; dhe (iii) mungesën e mjeteve financiare të z. Shala për përmbushjen e Urdhrit për Zhdëmtim, d.m.th. pamundësinë e tij për të paguar aktualisht shumën e zhdëmtimit.<sup>379</sup>

223. Në rast se Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit do të miratojë fonde për kompensim, ato duhet t'i transferohen Administratores në përputhje me nenin 53(4) dhe (5) të Ligjit. Nga ana e saj, Administratorja eventualisht duhet t'ua ndajë viktimave shumën e kompensimit në mënyrë proporcionale.<sup>380</sup>

224. Për çdo veprim të ndërmarrë në lidhje me Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Administratorja duhet t'i raportojë Gjykatësit të Vetëm të caktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim.<sup>381</sup>

---

<sup>379</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 267.

<sup>380</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 268.

<sup>381</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 269.

225. Pavarësisht nga sa më sipër, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se viktimat mund të mos marrin shumën e plotë të kompensimit të akorduar nga Trupi Gjykses nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimin, duke pasur parasysh shumën maksimale që mund të akordohet në kuadër të këtij programi.<sup>382</sup> Për rrjedhojë, për vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim duhet të shqyrtohet mundësia e përdorimit të instrumenteve të tjera të zbatimit.<sup>383</sup>

b) Krijimi i një mekanizmi të ri zhdëmtues në Kosovë

226. Trupi Gjykses rikujton se, në kontekstin e procesit *Mustafa*, Ministria e Drejtësisë e Kosovës informoi Trupin Gjykses se për krijimin e një fondi ose programi të ri posaçërisht për kompensimin e viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së, duhet që organi legjislativ i Kosovës të miratojë një ligj të posaçëm, si ai për financimin e mbrojtjen e personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHS-së.<sup>384</sup>

227. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vë në dukje se, ndonëse Kosova parashikoi nevojën për të mbështetur financiarisht mbrojtjen e personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHS-së, ajo ende nuk ka marrë masa për t'u përgatitur posaçërisht për mundësimin e zhdëmtimit të viktimave të krimeve të përfshira në

---

<sup>382</sup> *Shih në lidhje me këtë* nenet 11-17 të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)), ku për çdo lloj dëmi përcaktohet shuma maksimale që mund të akordohet nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimin. Në veçanti, Trupi Gjykses thekson se, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)), shuma maksimale e kompensimit në rast të lëndimit fizik apo dëmtimit të shëndetit është 4.000 (katër mijë) euro për lëndime, dëmtime apo sëmundje të rënda, shumë e cila mund të rritet deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro në rrethana të jashtëzakonshme, ndërsa shuma maksimale e kompensimit në rast të dëmtimit të shëndetit mendohet shkaktuar nga një krim i dhunshëm dhe [në rast të] vuajtjes psikike – ndër të tjera edhe për shkak të humbjes së një anëtarit të familjes – sipas neneve 12-14 të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)), është 3.000 (tre mijë) euro për viktimat e drejtpërdrejta ose të tërthorta. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se sipas nenit 23(3.1) të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)): “Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimin, gjatë vendimmarrjes ka diskrecion [...] *tejkallimin e shumave maksimale të parashikuara për kategoritë e veçanta të kompensimit, në rastet kur shpenzimet e dokumentuara janë të arsyeshme*” [theksimi i shtuar].

<sup>383</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 270.

<sup>384</sup> [Ministry of Justice of Kosovo Response](#), (Përgjigjja e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 3-4; *shih, ngjashëm, Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 271.

juridiksionin e DHS-së, në rast se personi i shpallur fajtor nuk ka mjetet financiare për të përmbushur Urdhrin për Zhdëmtim.<sup>385</sup>

228. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson se në legjislacionin e Kosovës që trajton dëmet dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, nuk njihen dëmet e pësuar nga të gjitha viktimat gjatë luftës në Kosovë, pasi ai u referohet vetëm viktimave të shkaktuara nga forcat e armikut, d.m.th. forcave serbe, duke krijuar, për rrjedhojë, diskriminim midis viktimave të këtij konflikti të armatosur.<sup>386</sup>

229. Ndonëse nuk ka kompetencë të urdhërojë Kosovën që të paguajë shumat e kompensimit të akorduara për viktimat, Trupi Gjykues e konsideron të rëndësishme t'i kujtojë Kosovës detyrimet e saj në lidhje me të drejtën e viktimave për mjete juridike efektive, të mishëruara në nenin 54 të Kushtetutës, nenet 6(1) dhe 13 të KEDNJ-së, nenet 2(3) dhe 14(1) të KNDCP-së dhe në nenin 14 të KKT-së.<sup>387</sup> Kjo përfshin dhe detyrimin për të garantuar që këto mjete juridike të jenë të zbatueshme.<sup>388</sup>

<sup>385</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 272 dhe referencat aty.

<sup>386</sup> *Shih para. 189 më lart; shih, ngjashëm Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 273.

<sup>387</sup> *Shih nenin 14 të KKT-së; Committee against Torture, General Comment No. 3, Implementation of article 14 by States parties, CAT/C/GC/3 (2012)*, para. 5; *Declaration of Basic Principles of Justice*, para. 4-5, 12-13; *UN Basic Principles on Reparations*, para. 16.

<sup>388</sup> GJEDNJ-ja është shprehur se detyrimi i shteteve sipas nenit 13 të KEDNJ-së përfshin edhe detyrimin për të garantuar që ky mjet juridik të jetë i zbatueshëm, pasi miratimi i mjetit juridik pa garantuar zbatimin e tij do të ishte i papajtueshëm me parimin e shtetit ligjor (ECtHR, *Elvira Dmitriyeva v Russia*, nos. 60921/17 and 7202/18, *Judgment*, 9 September 2019, para. 63; *VK v Croatia*, no. 38380/08, *Judgment*, 29 April 2013, para. 114; *Kenedi v Hungary*, no. 31475/05, *Judgment*, 26 August 2009, para. 47; *Kaić and Others v Croatia*, no. 22014/04, *Judgment*, 17 October 2008, para. 40; *Z and Others v the United Kingdom*, no. 29392/95, *Judgment*, 10 May 2001, paras 110-111). Gjithashtu, në Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet përcaktohet se, në rastet e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, e drejta e viktimave për mjete juridike përfshin, sipas të drejtës ndërkombëtare, qasje të barabartë dhe efektive në drejtësi dhe zhdëmtim të përshtatshëm, efektiv dhe pa vonesë për dëmin e pësuar. Më konkretisht, sipas këtyre parimeve, shtetet duhet të përpiqen të krijojnë programe shtetërore për zhdëmtim dhe ndihmë tjetër për viktimat në rast se palët përgjegjëse për dëmin e pësuar nuk janë në gjendje ose nuk duan t'i përmbushin detyrimet e veta. Së fundi, në to përcaktohet se shtetet duhet të ofrojnë mekanizma efektive për zbatimin e aktvendimeve për zhdëmtim sipas ligjeve të tyre shtetërore. *UN Basic Principles on Reparations*, para. 11(a)-(b), 16, 17).

230. Në këtë aspekt, duke qenë se ende bëhet dallim midis, nga njëra anë, viktimave të shkaktuara nga forcat e “armikut” që janë duke marrë pensione (të konsiderueshme) sipas legjislacionit të Kosovës dhe, nga ana tjetër, viktimave të krimeve të kryera nga anëtarët e UÇK-së në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë, që janë përjashtuar nga përfitimi i këtyre pensioneve dhe ndihmave të tjera (të konsiderueshme),<sup>389</sup> Trupi Gjykses kërkon përsëri që Kosova të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm zhdëmtues për kompensimin e plotë të viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së. Kjo do të garantonte gjithashtu trajtim të barabartë<sup>390</sup>, brenda sistemit ligjor të Kosovës, midis viktimave dhe personave të dyshuar ose të akuzuar në DHS, duke pasur parasysh se në legjislacionin ekzistues të Kosovës tashmë parashihet mbështetja financiare për mbrojtjen ligjore të personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHS-së, pa u kërkuar personave të dyshuar ose të akuzuar prova për mungesën e mjeteve financiare dhe madje parashihet kompensim në rast të shpalljes së tyre të pafajshëm, ndërkohë që nuk parashihet asgjë konkrete për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së.<sup>391</sup>

231. Çka është më e rëndësishme, ky mekanizëm i ri zhdëmtues për këto viktima duhet të jetë i pavarur, asnjans dhe i çliruar nga aspektet politike. Gjithashtu, ai duhet të përfshijë një proces për paraqitjen e kërkesave që t’u përgjigjet vështirësive me të cilat përballet DHS-ja dhe, në veçanti, masa për mbrojtjen e viktimave që bëjnë kërkesë në kuadër të këtij mekanizmi, ndër të cilat edhe masat e urdhëruara në lidhje me viktimat pjesëmarrëse në proceset e DHS-së.<sup>392</sup>

232. Krahas kësaj, duhet të konsiderohet mundësia e financimit të mekanizmit zhdëmtues nga buxheti i Kosovës, duke qenë se edhe mbrojtja e personave të dyshuar

---

<sup>389</sup> *Shih* para. 189 më lart.

<sup>390</sup> *Shih* nenin 24 të Kushtetutës.

<sup>391</sup> *Shih* para. 227 më lart; *shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 276.

<sup>392</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa* ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 276.

dhe të akuzuar në proceset e DHS-së financohet nga ky buxhet.<sup>393</sup> Përdorimi në mënyrë të barabartë i buxhetit të Kosovës do të ndihmonte zbatimin e mandatit të DHS-së sipas nenit 1(2) të Ligjit, mbështetur nga Kosova, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet e tjera kontribuese (Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës), në kuadër të themelimit të DHS-së dhe mbështetjes financiare të punës së saj.<sup>394</sup> Në lidhje me këtë, Komisionin Evropian ka theksuar kohët e fundit se:

Kosova ka krijuar një fond që u jep ndihmë juridike të akuzuarve në Dhomat e Specializuara të Kosovës, si dhe mbështetje financiare familjeve të tyre, pa asnjë dëshmi për ekzistencën e nevojave financiare. Megjithatë, deri më tani nuk është vënë në dispozicion asnjë mbështetje financiare për viktimat për të cilat Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë konstatuar se kanë vuajtur si pasojë e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë lëshuar urdhrin e parë për zhdëmtimin e viktimave. Rrjedhimisht, nuk është e qartë se si do të kompensohen viktimat në mungesë të fondeve nga të akuzuarit apo të një fondi të Kosovës për këtë qëllim. Është thelbësore që Kosova ta trajtojë këtë pabarazi në trajtim.<sup>395</sup>

233. Në mënyrë të veçantë mund të shqyrtohet mundësia që në këtë mekanizëm zhdëmtues të kenë qasje edhe viktimat të tjera të cilat provojnë në masë të mjaftueshme se kanë pësuar dëm brenda parametrave dhe kuadrit të çështjes gjyqësore sikurse janë përcaktuar në Aktgjykim.<sup>396</sup> Megjithatë, kjo nuk ka ndikim në përgjegjësinë e personit

---

<sup>393</sup> *Shih* nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-054 ([Law No. 05/L-054](#)).

<sup>394</sup> *Shih* nenin 162 të Kushtetutës ([Article 162 of the Constitution](#)) dhe Shkëmbimin e Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë të 14 prillit 2014 ([Law No. 04/L-274 on Ratification of the International Agreement between the Republic of Kosovo and the European Union on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo](#), (Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014).

<sup>395</sup> European Commission, Doc. No. SWD(2023) 692 final, [Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions: 2023 Communication on EU Enlargement policy](#), 8 November 2023, p. 23.

<sup>396</sup> Në lidhje me këtë Trupi Gjykses rikujton se provat e paraqitura gjatë gjykimit vërtetuan se në FMK kishte më shumë të ndaluar se sa individët e diskutuar në Aktgjykim, *shih* Aktgjykimin ([Trial Judgment](#)), para. 589 dhe referencat aty.



të shpallur fajtor, përcaktuar në urdhrin për zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjykes në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.<sup>397</sup>

234. Së fundi, Trupi Gjykes rikujton se, sipas nenit 22(2) të Ligjit, në rast se një viktimë nuk paraqet kërkesë për të marrë pjesë në proces në Dhomat e Specializuara, ose nuk është pranuar si pjesëmarrës apo nuk është përcaktuar të jetë viktimë sipas Ligjit, kjo nuk kufizon të drejtat e tij ose të saj të përcaktuara në ligje të tjera ose përmes mekanizmave të tjerë zhdëmtues në Kosovë.<sup>398</sup>

### 3. Nga DHS-ja

235. Trupi Gjykes vë në dukje se pasuria që zotëron aktualisht z. Shala dhe shumat maksimale që është e mundur ose e lejueshme të akordohen nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit sipas legjislacionit aktual, janë gjithsesi të pamjaftueshme për të mbuluar kompensimin e plotë të akorduar nga Trupi Gjykes viktimave në këtë Urdhër për Zhdëmtim.<sup>399</sup> Megjithatë, Trupi Gjykes thekson se, në qoftë se viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim,<sup>400</sup> kjo e drejtë, e mishëruar në nenin 22(3) të Ligjit, bëhet e pakuptimtë.<sup>401</sup>

236. Për këtë arsye, në kontekstin e procesit *Mustafa*, Trupi Gjykes rekomandoi që, me nismën e DHS-së dhe nën administrimin e Administratores, të krijohet një fond për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së.<sup>402</sup> Trupi Gjykes thekson se ky fond duhet të mbështetet financiarisht në radhë të parë nga Kosova,

---

<sup>397</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 278.

<sup>398</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 279.

<sup>399</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 281.

<sup>400</sup> Në lidhje me të drejtën për mjet juridik efektiv, *shih* para. 229-230 më lart.

<sup>401</sup> *Shih, ngjashëm, Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 280.

<sup>402</sup> *Shih Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa (Mustafa Reparation Order)*, para. 281, 282 dhe 283.

duke pasur parasysh detyrimet e saj ndaj viktimave të përshkruara më lart,<sup>403</sup> si edhe nga shtete dhe donatorë të tjerë që dëshirojnë të mbështesin viktimat.<sup>404</sup>

237. Në këtë aspekt Trupi Gjykses thekson se aktualisht ekziston një mundësi që DHS-ja të marrë donacione vullnetare të paspecifikuara si kontribut për pagimin e zhdëmtimeve që u akordohen viktimave me një urdhër përfundimtar për zhdëmtim të lëshuar nga DHS-ja.<sup>405</sup>

238. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson edhe një herë se ekzistenca e kësaj mundësie përmes DHS-së nuk e liron në asnjë mënyrë: (i) zotin Shala nga detyrimi për të kompensuar tetë viktimat në përputhje me Urdhrin për Zhdëmtim, dhe (ii) Kosovën nga përmbushja e detyrimeve të saj ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi zhdëmtues, sikurse sugjerohet në pjesën VII.B.2(b) të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

## VIII. VENDIM

239. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **LËSHON** Urdhrin për Zhdëmtim kundër z. Shala;
- b) **KONSTATON** se V01/04, V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 kanë vërtetuar, në bazë të standardit të vërtetimit të tërësisë së gjasave, se janë viktime të krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor;
- c) **VENDOS** t'u akordojë zhdëmtime V01/04-ës, V02/04-ës, V03/04-ës, V04/04-ës, V05/04-ës, V06/04-ës, V07/04-ës dhe V08/04-ës;

---

<sup>403</sup> Shih para. 229 më lart.

<sup>404</sup> Shih Urdhrin për Zhdëmtim në Çështjen Mustafa ([Mustafa Reparation Order](#)), para. 282.

<sup>405</sup> Donatorët e mundshëm mund të dërgojnë pyetje në lidhje me zhdëmtimin e viktimave të përfshira në juridiksionin e DHS-së në adresën: [info.donations.reparations@scp-ks.org](mailto:info.donations.reparations@scp-ks.org).

- d) **AKORDON** zhdëmtim individual në formë kompensimi për viktimën V01/04 përkatësisht, për dëmin fizik, mendor dhe material të tij; dhe zhdëmtime individuale dhe kolektive në formën e kompensimit për V02/04-ës, V03/04-ën, V04/04-ën, V05/04-ën, V06/04-ën, V07/04-ën dhe 08/04-ën, përkatësisht për dëmin mendor dhe material të tyre;
- e) **CAKTON** shumën e zhdëmtimit për të cilin z. Shala është përgjegjës, në 208.000 euro;
- f) **URDHËRON** z. Shala t'i paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:
- V01/04-ës: 10.000 euro për dëm fizik; 30.000 për dëm mendor dhe 60.000 euro për dëm material; dhe
  - V02/04-ës: 8.000 euro për dëm mendor;
  - V03/04-ës: 10.000 euro për dëm mendor;
  - V04/04-ës: 8.000 për dëm mendor;
  - V05/04-ës: 8.000 euro për dëm mendor;
  - V06/04-ës: 8.000 euro për dëm mendor;
  - V07/04: 8.000 euro për dëm mendor;
  - V08/04-ës: 8.000 euro për dëm mendor; dhe
  - V02/04-V08/04, kolektivisht: 50.000 euro për dëm material;
- g) **KONSTATON** se, në këtë fazë, z. Shala i mungojnë mjetet financiare për zbatimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- h) **URDHËRON** Administratoren të marrë masat e nevojshme për vënien në jetë të Urdhrit për Zhdëmtim;

- i) **FTON** Kryetaren e DHS-së të caktojë një Gjykatës të Vetëm për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- j) **FTON** Kosovën të krijojë një mekanizëm të ri zhdëmtues për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHS-së për të korrigjuar pabarazitë aktuale në sistemin ligjor të Kosovës, sikurse përshkruhet në këtë Urdhër për Zhdëmtim; dhe
- k) **URDHËRON** Administratoren t'ia përcjellë këtë Urdhër për Zhdëmtim, në versionin e redaktuar publik të tij, Qeverisë së Kosovës.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 29 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë.